



ISSN 2671-3004

INTERKULTURA

Komunikimi interkulturor

1



INTERKULTURA

NR.1

Fq.1-115

Shkup

2018



INTERKULTURA

Komunikimi interkulturo

1

Botimi i kësaj reviste është mbështetur nga:



Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë

Shkup, 2018



INTERKULTURA

1

Botues

Universiteti "Nënë Tereza" Shkup
Aziz POLLOZHANI - rektor

Editor

Mother Teresa University , Skopje
Aziz POLLOZHANI - rector

Redaktori përgjegjës

Mustafa IBRAHIMI

Editor-in-chief

Mustafa IBRAHIMI

Këshilli botues:

Rizvan SULEJMANI
Sunaj RAHIMI
Agron KURTISHI
Zeqirja NEZIRI
Mirjana MALEVSKA
Rubin ZEMON

Editorial board:

Rizvan SULEJMANI
Sunaj RAHIMI
Agron KURTISHI
Zeqirja NEZIRI
Mirjana MALEVSKA
Rubin ZEMON

РЃРМВАЈТЈЕ - СОДРЖИНА

<i>РЃРМВАЈТЈЕ - СОДРЖИНА</i>	3
Zeqirja NEZIRI	5
<i>АСПЕКТЕ НДЃРКУЛТУРОРЕ ТЃ КАНЦЕЛАРИСЃ СЃ СКЃНДЕРБЕУТ</i>	5
<i>ИНТЕРКУЛТУРНИ ОДНОСИ ВО КАНЦЕЛАРИЈАТА НА СКЕНДЕРБЕГ</i> .	5
Mustafa IBRAHIMI	13
<i>КОНЦЕПТЕ, ДАЛЛИМЕ ДНЕ КОНФЛИКТЕ ТЃ МУЛТИКУЛТУРАЛИЗМИТ</i> <i>РЃРБАЛЃ ГЛОБАЛИЗМИТ</i>	13
<i>КОНЦЕПТИ, РАЗЛИКИ И КОНФЛИКТИ НА МУЛТИКУЛТУРАЛИЗМОТ</i> <i>НАСПРОТИ ГЛОБАЛИЗМОТ</i>	13
Rizvan SULEJMANI	27
<i>ЗГЈИДНЈА Е КОНФЛИКТЕВЕ НДЃРЕТНИКЕ – РАСТИ И МАЃЕДОНИСЃ</i>	27
<i>РЕШАВАЃЕ НА МЕЃУЕТНИЧКИТЕ КОНФЛИКТИ – СЛУЧАЈ СО</i> <i>МАКЕДОНИЈА</i>	27
Avzi MUSTAFA	43
<i>КУФИРИ НДЃРМЈЕТ КУЛТУРАВЕ ТЃ НДРЈШМЕ, ВЃШТРУАР РЃРМЕС</i> <i>РОМАНИТ “БАЛКАНБАБИЛОНАСИТ” ТЃ ЛУАН СТАРОВЃС</i>	43
<i>ГРАНИЦАТА ПОМЕЃУ РАЗЛИЧНИТЕ КУЛТУРИ, ГЛЕДАНО ПРЕКУ</i> <i>ПРИЗМАТА НА РОМАНОТ „БАЛКАНОБАБИЛОНИЈА,, НА ЛУАН СТАРОВА</i>	43
Gjylmser KASAPI	51
<i>ДАЛЛИМЕТ ДНЕ НГЈАШМЃРИТЃ НЃ КУЛТУРАТ Е ФАМИЈЕВЕ МАЃЕДОНАСЕ</i> <i>ДНЕ ШЃИПТАРЕ НЃ МАЃЕДОНИ</i>	51
<i>РАЗЛИКИТЕ И СЛИЧНОСТИТЕ ВО КУЛТУРИТЕ НА МАКЕДОНСКИТЕ И</i> <i>АЛБАНСКИТЕ СЕМЕЈСТВА ВО МАКЕДОНИЈА</i>	51



Sefer TAHIRI	59
<i>SKICË PËR MBINDËRTIMIN E MAQEDONISË SHUMËKULTURORE DHE NDËRKULTURORE</i>	<i>59</i>
<i>СКИЦА ЗА ДОИЗГРАДБА НА МУЛТИКУЛТУРНА И ИНТЕРКУЛТУРНА МАКЕДОНИЈА</i>	<i>59</i>
Rubin ZEMON - Рубин ЗЕМОМ	79
<i>СОВРЕМЕНИТЕ ПРЕДИЗВИЦИ НА УПРАВУВАЊЕТО СО ДИВЕРЗИТЕТНИ ОПШТЕСТВА</i>	<i>79</i>
<i>SFIDAT BASHKËKONHORE NË DREJTIMIN E SHOQËRIVE TË DIVERSITETIT</i>	<i>79</i>
Mirjana MALESKA – Мирјана МАЛЕСКА	91
<i>МУЛТИКУЛТУРАЛИЗАМ-ПЛУРАЛИСТИЧКА И ТОЛЕРАНТНА КОНЦЕПЦИЈА ЗА ИНТЕГРАЦИЈА</i>	<i>91</i>
<i>MULTIKULTURALIZMI - KONCEPTI PLURALIST DHE TOLERUES PËR INTEGRIM.....</i>	<i>91</i>
Kosta MILLKOV - Коста МИЛКОВ.....	99
<i>ЧИЈА Е ЗЕМЈАТА? КУЛТУРОЛОШКОТО И ТЕРИТОРИЈАЛНО РАЗГРАНИЧУВАЊЕ ВО КОНТЕКСТ НА БАЛКАНСКИТЕ КОНФЛИКТИ И БЛИСКОИСТОЧНАТА БЕГАЛСКА КРИЗА</i>	<i>99</i>
<i>I KUJT ËSHTE VENDI? KUFIZIME KULTURORE DHE TERRITORIALE NË KONTEKST TË KONFLIKTEVE BALLKANIKE DHE KRIZA E REFUGJATËVE NË LINDJEN E MESME.....</i>	<i>99</i>

UDC 316.723:341.7
Punim studimor

Zeqirja NEZIRI

Universiteti 'Shën Cirili dhe Metodi

Fakulteti i Filologjisë 'Blazhe Koneski' Shkup, Maqedoni

zeqirjaneziri@yahoo.com

ASPEKTE NDËRKULTURORE TË KANCELARISË SË SKËNDERBEUT

ИНТЕРКУЛТУРНИ ОДНОСИ ВО КАНЦЕЛАРИЈАТА НА СКЕНДЕРБЕГ

Summary

The study focuses on two points: (1) Affirmation of Skanderbeg in Europe; and (2) his political and diplomatic relations with albanian princes and foreign researchers.

*(1) Marin Barlet with his act *Historia de la vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum principis* (Rome 1508-1510) three times republished: 1537, 1578 and 1743 made him famous all around Europe. To universalise his figure helped him the seven times translation and republication in european languages english (Z. J., London 1596); french by Zhak de Lavardin (5 times: 1576, 1597, 1621, 1593, 1604); german by Johan Piniciani (seven times: 1533, 1561, 1577, 1578, 1597, 1606); italian by Petro Roka (four times: 1554, 1560, 1568, 1580); polonian by Cyprian Banliku (three times: 1568, 1569 and 1587); portugese by F. de Andrades (1567); and spanish by Ochoa Joan de Saldes (1582, 1588, 1592 and 1597)(Prifti 1964: 10-11).*

(2) Based on the historical documentation of the time the diplomatic aspect of Skanderbeg can be placed in two points: internal and external.

*Skanderbeg relations with albanian princes can generally be said to have been friendly. This is evidenced in the Lezha assembly (march 1444) and the presence of some of them: **Gjergj Arianit, Andrea Topia** (Thopia), **Teodor Korona Muzaka**, **Lekë Zaharia, Gjergj Stres***

Balsha, Pal and Nikolla Dukagjin (Barlet 1964: 90-91, 100; Gjergj Kastrioti 1967: 46-47, 50-52, 66-67, 90-93)

In the outer archive is stored the cooperative documentation of his chanery with foreign chanceries of the time. As more intense is the cooperation with Alfons V and his son Ferdinand I; than with Vatikan, Dubrovnik, Venezia; the king Vladislav and Jan Huniad, and the hungarian king Matija Korvin; Brankovic-s and Ottoman Empire.

Hyrje

Ky takim mbahet nën hijen e 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Sot, duke e përkujtuar këtë përvjetor kujtojmë jo vetëm një burrë shteti, komandant, strateg e luftëtar të madh, por dhe një epokë që mban emrin e tij, një nga epokat më të lavdishme të historisë së kombit tonë, në të cilën populli ynë dha ndihmesën e tij drejt krijimit të kohës së re.

Skënderbeu jetoi në një periudhë shumë të rëndë historike, në kapërcimin nga periudha e Mesjetës në lindje të periudhës së re, moderne. Jetoi në periudhën e Humanizmit, që bëri një kthesë të madhe në historinë e njerëzimit: kalimin nga misticizmi në materializëm. Studimi përqendrohet në dy pika: (1) afirmimin e Skënderbeut në Evropë; dhe (2) marrëdhëniet e tij politike e diplomatike me princat shqiptarë dhe sundimtarë të huaj.

Skënderbeu figurë historike shqiptare dhe universale

Lëvizja e Humanizmit synonte ta shprehë vlerësimin e njeriut si genie njerëzore, fizike e biologjike. Me të drejtë është vënë në dukje, se Barleti nuk mund të gjente ndonjë subjekt më të përshtatshëm për të treguar entuziazmin e tij humanist për madhësinë e njeriut. Në kontekst të këtyre kërkesave humaniste ai ndërtoi një figurë letrare madhështore, ku sublimoheshin ndjenjat e larta njerëzore, morale e fizike: të fuqishëm e të zgjuar, të aftë të ndërmarrë aksione të llojllojshme dhe vazhdimisht të dalë fitimtar. Ndërtimi fizik i personazhit, shpjegohet si pasojë e veprimit të dy forcave: dashurisë së madhe të sulltanit për të krijuar prej tij një vazal e nënshtrues të përjetshëm dhe vullnetit të madh e dëshirës së pakufishme të Gjergjit për t'i absorbuar të gjitha mundësitë që i jepeshin. Këto parime diti t'i shfrytëzojë për qëllime të mëdha njerëzore: *lirinë personale dhe lirinë e mjedisit në të cilin jetoi.*

Në figurën e tij Marin Barleti ka gërshetuar dy nga kërkesat teorike të Humanizmit (aktuale edhe sot): *të ngritjes fizike të personalitetit të thjeshtë njerëzor në një figurë mitike e legjendare*, e cila fuqinë trupore me ndihmën e fuqisë së mendjes diti ta fuqizojë në të mirë të njerëzimit.

Barleti e percepton dhe e trajton heroin nga pikëpamja filozofike e estetike e Humanizmit evropian. Heroi i Barletit është madhështor, i idealizuar deri në gjysmëperëndi, sepse i shërben një ideali të lartë dhe respekton njeriun, popullin, për lirinë e të cilit ai sakrifikon gjithçka (Idrizi 1990: 33-34). Në veprën e tij Barleti shkriu gjithë aftësitë, talentin, pasionin për të krijuar figurën e një luftëtari të madh, të një prijësi që udhëheq një luftë të drejtë. Ai shkruan për një prijës legjendar, që tashmë ka vdekur, të cilit i detyrohet për veprën e madhe që ka kryer ndaj atdheut dhe çështjen e madhe që mbrojt.

Shembull guximi e trimërie

Shkruan mbi Skënderbeun, që ky të jetë edhe në të ardhmen një shembull guximi e sakrifice për lirinë e atdheut e të njerëzimit. Barleti krijoi një figurë të bukur të Skënderbeut, ashtu si dhe te biografitë e tjera të periudhës së Humanizmit, siç qenë Simoneta, Xhivo, Nazoli, Saseti, Mafei, Vasari, Mori, Koleti, Baldi, me gjithë përpyekjet për të dhënë psikologjinë e heroit, kemi më tepër portretizimin e tij (Idrizi 1990: 36).

Skënderbeu i Barletit nuk është vetëm prijësi i madh shqiptar që luftoi për lirinë e popullit të tij, por edhe njeriu i ri i kohës, përfaqësues i epokës së Rilindjes Evropiane. Ai vlerëson mbi gjithçka vullnetin, energjinë krijuese të njeriut, i beson gjykimit, arsyes së shëndoshë dhe adhuron lirinë, tipare këto që shtroheshin si program dhe kërkoheshin nga çdo krijues i periudhës së Humanizmit.

Për këto arsye Skënderbeu për së gjalli u bë një burrështetas i admiruar evropian e universal dhe një hero shqiptar. Në këtë drejtim edhe Marin Barleti dha ndihmesën e tij dhe u bë i famshëm me veprën e tij *Historia de vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum principis* (botuar në Romë midis viteve 1508-1510). Në gjuhën e origjinalit, libri është ribotuar tri herë (Argentorat-Strasburg të Gjermanisë 1537; Frankfurt mbi Majn 1578; dhe Zagreb 1743).

Përgjatë shekullit XVI ky libër u përkthye në shtatë gjuhë evropiane: *anglisht* (nga Z. J., Londër 1596); *frëngjisht* nga *Zhak dë*

Lavardin (u botua 5 herë: 1576, 1597, 1621, 1593, 1604); *gjermanisht* nga *Johan Piniciani* (u botua shtatë herë: 1533, 1561, 1577, 1578, 1597, 1606); *italisht* nga *Petro Roka* (katër botime në Venedik: 1554, 1560, 1568, 1580); *polonisht* nga *Cyprian Banliku* (tri botime: 1568, 1569 dhe 1587); *portugjisht* nga *F. de Andrades* (u botua në Lisbonë më 1567); dhe *spanjisht* nga *Ochoa Joan de Saldes* (katër botime: 1582, 1588, 1592 e 1597)(Prifti 1964: 10-11).

Në shekujt vijues është përshtatur në: *fëngjisht* nga *P. Jean Duponcet* (Paris 1709); *greqisht* nga *Jani Baila* (Moskë, 1812). Ky botim u përkthye edhe italisht nga *Papadopulo - Vreto*; *hungarisht* është përshtatur në vjershë nga *Niccolo Bogati Fazekas* (Kluzh, Rumani, 1592); *kroatisht* u përshtat në vargje nga *Andrija Kačić Miošići* (Venedik 1759) dhe nga *Ludevit Gaji* ("Danica ilirska", 1838-1839)(Neziri 1998: 74).

Stolisja e figurës së Skënderbeut me dy kategori estetike e morale

Falë bëmave madhore të Gjergj Kastriotit dhe penës magjike me të cilën Marin Barleti diti t'i jetësojë këto vepra në librin kushtuar këtij fatosi, për një kohë shumë të shkurtër, një gjysmë shekullore Skënderbeu do të bëhet i pavdekshëm në historinë e shqiptarëve e të popujve të Evropës dhe të Botës. Vepra e tij në historinë e kësaj periudhe të Evropës vlerësohet si një ndihmesë e madhe dhe shumë e rëndësishme e shqiptarëve dhënë ndërtimit të historisë së re të popujve të Evropës.

Roli i tij në historinë e jetës së popujve të Evropës e të shqiptarëve, falë kësaj vepre të Barletit, nga perspektiva e të sotmes mund të studiohet nga dy këndvështrime: (a) të shekullit XVI-XVII, kur kujtesa historike për të akoma ishte e freskët; dhe (b) të periudhave vijuese.

Në kohën kur u botua libri i Barletit, pra në *periudhën e parë* (shekujt XVI-XVII), në shembullin e ideve të Barletit gjithandej Evropës e Botës lindën vepra letrare e historike, muzikore e teatrale, të cilat krenoheshin me figurën e Skënderbeut, duke ngritur veprat dhe bëmat e tij në përmasa fantastike (Kostallari 1969: 371-394). Numri i tyre është i jashtëzakonshëm: mbi 2000 tituj. Kështu figura e tij u stolis me epitetet më fisnike të kategorive estetike dhe u bë:

(1) një figurë universale evropiane e botërore; dhe

(2) një figurë kombëtare shqiptare për të drejtën dhe lirinë e njeriut.

Në *periudhën e dytë* (në shekujt XVIII-XX) në figurën e tij, krahas figurave të tjera evropiane e botërore shihej modeli i prijësit, strategut e udhëheqësit shembullor. Po japim vetëm një shembull: në indeksin e publicistikës, artit, letërsisë dhe historiografisë së Rilindjes Kroate Skënderbeu kishte indeksin 42, shumë më të lartë se sundimtarët rusë (Petrit 38 e Aleksandrit 28) dhe luftëtarit kroat Nikola Shubiç Zrinski që kishte indeksin 24 (Flaker 1976: 146). Ky është vetëm njëri prej treguesve të shumtë që flet për kategorinë universale të Skënderbeut.

Aspekte të Kancelarisë së Skënderbeut

Studimi i Kancelarisë së Skënderbeut jep një pasqyrë tjetër të figurës së tij: flet për aspektin politik e diplomatik. Në këtë kontekst profesor Zija Xholi, duke parafrazuar Barletin thekson se: “Rreziku nuk e kishte bërë Skënderbeun të mbyllej në vetvete; atdhedashuria /.../ nuk e kishte izoluar nga popujt e tjerë. Kështu, një element të forcës së shtetit, një themel të pathyeshmërisë së mbretërisë Skënderbeu e shihte në miqtë dhe aleatët që mund t’i kishte” (Xholi 2003: 55). Mbështetur në të dhënat e biografisë së tij, Marin Barleti, si dhe në dokumentacionin historik të kohës ky angazhim mund të sheshohet në dy plane: *të brendshëm* dhe *të jashtëm*.

Sa i përket planit të parë të *marrëdhënieve të Skënderbeut me sundimtarë të brendshëm*, me princat shqiptarë, përgjithësisht ka mbajtur marrëdhënie të mira. Kjo dëshmohet me organizimin e Kuvendit të Lezhës (mars 1444) dhe pjesëmarrjen në të të disa prej tyre, si: [Gjergj Arianitit](#), [Andrea Topias](#) (Thopia), [Teodor Korona Muzakë](#), Lekë Zaharisë, [Gjergj Stres Balshës](#), [Pal dhe Nikollë Dukagjini](#) (Barleti 1964: 90-91, 100; Gjergj Kastrioti 1967: 46-47, 50-52, 66-67, 90-93).

Me një pjesë të tyre ka pasur marrëdhënie të shkëlqyera, por me disa jo fort të mira. Me një pjesë ka lidhur edhe marrëdhënie familjare, si ato me Aranitin (Shuteriqi 1969: 91-100). Marrëdhënie pjesërisht të mira ka pasur edhe me Dukagjinët. Për këto të fundit flitet edhe në një gojëdhënë, ku thuhet se Skënderbeu me Lekë Dukagjinin, në punë të kanunit shpeshherë kanë debatuar. Një prej tyre është edhe pleqërimi i gjaqeve (Epika 1: 142-143). Kjo jep të kuptohet se marrëdhënie e marrëveshje midis principatave vendëse

kanë ekzistuar, por këto, në shekujt vijues janë përcjellë gojarisht dhe, si të shkruara, nëse kanë ekzistuar janë zhdukur si pasojë e luftimeve të gjata përgjatë vendosjes së sundimit osman. Për ekzistimin e tyre flet edhe vetë Skënderbeu, në një letër të 31 tetorit të vitit 1460 dërguar princit të Torontos (Gjergj Kastrioti 1967: 68-80). Në të përmenden “kronikat tona”. E vetmja kronikë e kësaj kohe është ajo e Muzakës që u botua më vonë (1510) në italisht.

Mirëpo, nëpër arkivat e jashtme ruhet dokumentacioni i bashkëpunimit të Kancelarisë së tij me kancelari të huaja të kohës. Më intensiv na del bashkëpunimi me Alfonsin V dhe birin e tij Ferdinandin I; pastaj me Vatikanin, Dubrovnikun; mbretin Vladislav e Jan Huniadin; Brankoviqët dhe me sundimtarët osmanë.

Derisa me mbretin aragonas Alfonsin V e mbretin e Polonisë Vladislavin, si dhe me luftëtarin Jan Huniadi e mbretin hungarez Matija Korvin ka pasur një bashkëpunim të ngushtë, ky lloj bashkëpunimi nuk është reflektuar në marrëdhëniet me Venedikun, aq më pak me Brankoviqët ose me osmanët.

Marrëdhëniet e bashkëpunimit të Skënderbeut me aragonët janë zhvilluar (jo vetëm në ndihma materiale e në mjete lufte, por edhe në ushtarë, njësoj siç e ka ndihmuar në një masë më të kufizuar edhe Vladislavi i Polonisë dhe Matija Korvini i Hungarisë (Gjergj Kastrioti 1967: 68; Pal 1969: 75-90). Kjo faktori se në ushtrinë e Skënderbeut ka pasur dhe ushtarë të shumë popujve evropianë, si anglezë, çekë e sllovakë, francezë, gjermanë, hungarezë, italianë, polakë.

Marrëdhënie të mira tregtare ka pasur edhe me Dubrovnikun. Nga Dubrovniku Skënderbeu kalon në Itali (më 1460) për ta ndihmuar mikun e tij, Ferdinandin I, të birin e Alfonsit V (Gjergj Kastrioti 1967: 80).

Marrëdhëniet me Venedikun kanë qenë shumë komplekse: herë të mira e herë të këqija, siç ndodhi konflikti i vitit 1447-1448. Këto marrëdhënie përmirësohen në vitet e fundit të sundimit të Skënderbeut, kur i jepet titulli "fisnik venecian" (1463) (Biçoku 1969: 67-74; Tirje 1969: 59-66; Listine 1890, IX: 283).

Marrëdhëniet e Skënderbeut me Papatin ishin moraliste: Papët e Romës e inkurajonin luftën e shqiptarëve dhe e propagandonin në vendet evropiane. Skënderbeun e cilësuan “Mbrojtës të krishterimit”, i dhanë titullin “Kapiten i përgjithshëm i Selisë së Shenjtë”; nuk mungoi edhe ndihma materiale. Si pasojë Papa Piu II organizoi një



ushtri prej 40.000 ushtarësh nga shtetet evropiane për t'u përballur me ushtrinë osmane, por me vdekjen e tij më 14 gusht 1464 u varrosën edhe shpresat e ngjallura prej tij (Naçi 1969: 53-58).

Marrëdhëniet e Skënderbeut me despotin serb, Gjergj Brankoviçin nuk patën rrjedhojë të pritshme. Skënderbeu pengohet nga ushtria e despotit të kalojë nëpër zotërimet e tij për ta ndihmuar Vladislavin e Huniadin (18 tetor 1448) (Listine 1890, IX: 268; Gjergj Kastrioti 1967: 81). Edhe pse, Skënderbeu më vonë, në Krujë do ta strehojë disa vjet Stefanin, të birin e Gjergj Brankoviçit (1459).

Marrëdhëniet e Skënderbeut me osmanët ishin kryesisht të natyrave të nënshkrimit të marrëveshjeve të armëpushimit (Gjergj Kastrioti 1967: 78-81).

Marrëdhëniet e Skënderbeut me vendet e Evropës i forcuan edhe vizitorët e vullnetarët e huaj që erdhën nga vende të ndryshme, deri nga Franca e Anglia dhe luftuan në ushtrinë e tij.

Bibliografi

- * * * * * (1967), *Gjergj Kastrioti – Akënderbeu dhe lufta shqiptaro – turke në shekullin XV*, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë.
- BARLETI, Marin (1964), *Histori e Skënderbeut*. Përkthyer nga Stefan I. Prifti. Tiranë.
- BIÇOKU, Kasem (1969), Disa aspekte të marrëdhënieve të Skënderbeut me Venedikun: *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (12-18 janar 1968) I*, Tiranë: 67-74.
- HAXHIHASANI, Qemal (përg. 1983), *Epika historike 1*, Folklor shqiptar III. Instituti i Kulturës popullore, Tiranë.
- FLAKER, Aleksandar (1976), *Stilske formacije*, Liber, Zagreb.
- KOSTALLARI, Androkli (1969), Figura e Skënderbeut në letërsinë botërore: *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (12-18 janar 1968) I*, Tiranë: 371-394.
- LJUBIĆ, Šime (1890), *Listine ob odnošajih izmedju južnoga slavenstva i mletačke republike (od godine 1423 do 1452.)*, knj. IX, Zagreb.
- NAÇI, Stavri (1969), Mbi marrëdhëniet e Papatit me Gjergj Kastriotin – Skënderbeun: *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (12-18 janar 1968) I*, Tiranë: 53-58.
- NEZIRI, Zeqirja (1998), *Historia e letërsisë shqiptare I*, Shkup.
- NOLI, Fan S. (1968), *Historia e Skënderbeut, kryezotit të Arbërisë (1405-1468)*, Beograd.
- PAL, Francisk (1969), Skënderbeu dhe Huniadi: *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (12-18 janar 1968) I*, Tiranë: 75-90.
- RADONIĆ, Jovan (1942), *Đurađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*. SPOMENIK SKAN 95, Beograd.
- SHUTERIQI, Dhimitër (1969), Marrëdhënjet midis Skënderbeut dhe Gjergj Aranitit në vitet 1449-1450: *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (12-18 janar 1968) I*, Tiranë: 91-100.
- TIRJE, Fredi (1969), Disa mendime rreth politikës së Venedikut ndaj Gjergj Kastriotit: *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (12-18 janar 1968) I*, Tiranë: 59-66.
- XHOLI, Zija (2003), *Pesë mendimtarë më të vjetër të kulturës sonë kombëtare*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë.

UDC _316.482.5-021.463-027.511

Punim studimor

MUSTAFA IBRAHIMI

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup

Fakulteti i Shkencave Sociale

E-mail: mustafa.ibrahimi@unt.edu.mk**KONCEPTE, DALLIME DHE KONFLIKTE TË
MULTIKULTURALIZMIT PËRBALLË GLOBALIZMIT****КОНЦЕПТИ, РАЗЛИКИ И КОНФЛИКТИ НА
МУЛТИКУЛТУРАЛИЗМОТ НАСПРОТИ ГЛОБАЛИЗМОТ**

Summary

From a historical perspective the cultural pluralism preceded the multiculturalism. The difference between these two is that cultural pluralism signifies equality, tolerance and an overt link among national cultures. On the other hand, multiculturalism refers to cultures that already exist on a sub national level. To decrease the level of nationalism means to create a society in which the treasure, the people and the ideas could freely circulate with no obstacles. The multilingual Macedonia has its own way that could not be inspired from other foreign models. As for the multicultural Europe, its originality comes from the huge lingual and cultural diversities. Moreover, the ruling of one idiom is not suitable at all, instead, the permanent openness toward diversities and cultural pluralism would lead freely to multiculturalism. For integration of all peoples, languages, and states, both traditional nationalism, which is characteristic of the European countries and the globalization process instigated by multinational companies and transnational institutions should find a middle ground.

Hyrje

Edhe pse në shumë fjalorë sociologjik, termi multikulturalizëm mungon, megjithatë ai është i pranishëm në politikën kulturore dhe në jetën praktike të shumë shteteve bashkëkohore. Multikulturalizmi në kontekstin historik është i vjetër sa vetë njerëzimi, kultura të ndryshme kanë gjetur mënyra që të bashkëjetojnë, respekti për diversitetin ishte një tipar i shumë perandorive, që nga perandoria osmane.

Ekzistojnë disa përkufizime lidhur me definimin e multikulturalizmit, njëri prej tyre e definon multikulturalizmin si “ *Një lëvizje politike, kulturore dhe sociale e cila synon të respektoj një shumëllojshmëri të perspektivave divergjente jashtë traditave dominante*” (Willet 1998) ose “Multikulturalizmi është mënyrë për të përshkruar se si struktura sociale krijohen për të ruajtur kultura të ndryshme në një shoqëri (Weker 1998). Sipas autorit Will Klymacka, profesor në universitetin e Otavës në Kanada subjektet kryesore janë: diversiteti, identiteti, të drejtat, kultura, tradita liberale dhe natyrisht multikulturalizmi. Charles Tayler është mbështetës i barazisë ndërmjet shumicës dhe pakicës, çdo grup në shoqëri duhet të jetë në gjendje të ushtrojë kulturën e tyre. Pra kur një kulturë e re vjen në kontakt me një vend të ri, vendi duhet ta mirëpres në mënyrë të barabartë.

Multikulturalizmin e karakterizon: Identiteti kulturor: të drejtën për të shprehur dhe ndarë trashëgimitë e tyre kulturore, duke përfshirë gjuhën edhe fenë. Drejtësia sociale: të drejtën e barazisë si dhe trajtimin e njëjtë pa dallim feje, gjuhe, race, kulture, gjinie, nacionaliteti. Ai paraqet një shoqëri heterogjene, gjegjësisht prezencën e shumë kulturave në një hapësirë të njëjtë, duke treguar qëllimin e bashkëjetesës së kulturave të ndryshme në një territor të caktuar. Gjithashtu qëllimi i multikulturalizmit si projekt politik në shtetet nacionale është stabiliteti politik; në mënyrë që shteti, duke institucionalizuar dhe mirëmbajtur financiarisht identitetin e grupeve pakicë, krijon stabilitet duke i integruar në shtet, por jo domosdoshmërisht duke i integruar në një identitet kulturor të përbashkët (në mënyrë që grupet pakicë mos të rebelohen dhe ta kërcënojnë stabilitetin e shtetit me kërkesat e tyre grupore), por së paku ta ndjejnë veten pjesë të shtetit.

Rrjedhimisht, multikulturalizmi si projekt politik i kushtohet shteteve nacionale si një zgjidhje për integrim të pakicave në shtet, sepse në shtetet nacionale nuk ekziston përfytyrimi dhe perceptimi i “shtetit të emigrantëve” ku për shembull të gjithë jemi më herët ose

më vonë emigrantë dhe ku nëpërmes procesit dhe dinamikës së bashkëshkrirjes barazohemi (asimilohemi) të gjithë në një identitet të përbashkët kulturor, siç është shembulli me identitetin amerikan.

Në thelb, multikulturalizmi është statik, zakonisht përveç kulturës dominuese pranon edhe shumë kultura të pakicave. Në plan të parë del *mbrojtja e kulturës dhe të drejtave të pakicës*. Shembull të tillë kishim në Kosovë, ku kjo mënyrë e trajtimit nuk solli suksese, për dallim nga kjo, Vojvodina, përherë synonte në barazimin e këtyre dy drejtimeve. Multikulturalizmi nuk do të jetë i kufizuar vetëm në thënie deklaruese të më shumë kulturave, brenda në një shoqërie, ajo këtyre kulturave do t'u jap fuqi të njëjtë, në të gjitha fushat e rregullimit shoqëror.

HISTORIA DHE SHKAQET E MULTIKULTURALIZMIT

Në vitin 1957 për herë të parë u përdor termi multikulturalizëm. Të parët që përdorën këtë term ishin zviceranët, duke marrë parasysh faktin se Zvicra është një vend ku fliten katër gjuhë me religjione të ndryshme. Që nga viti 1971 termi kishte ndryshuar nga gjuhë dhe religjione të ndryshme të një vendi në një vend multikulturor i cili pranoi emigrantët dhe kulturat e ndryshme. Qeveria e Kanadasë ishte e para që prezantoi multikulturalizmin si një urë që lidh kulturat e ndryshme si dhe ato të pakicave. Duke u mbështetur në fjalorin enciklopedik të Grant Robertit, mësojmë se ky term për herë të parë është përdorur në vitin 1971, në një fjalim të kryetarit të atëhershëm kanadez Pjer Tridoa, i cili ka thënë: “...*termi bikulturalizëm nuk e pasqyron sa duhet shoqërinë tonë. Fjala multikulturalizëm në këtë aspekt është më preciz*”.

Pas Kanadasë vijuan vendet si Britania e madhe, Holanda, Belgjika e kështu me radhë të cilët e futën multikulturalizmin në politikën e tyre dhe pranuan që kultura të ndryshme mund të koekzistojnë brenda një vendi. Është e rëndësishme që të kuptojmë se në një vend multikulturor kulturat e ndryshme nuk zhduken, por vetëm transformohen (Geuijen, 1998).

Gjatë periudhës së kolonizimit prej shekullit XV deri në shekullin XVII, shtetet si Portugalia dhe Franca u zhvendosën (placed settlements) në Afrikë dhe Amerikën Latine. Kolonizimi ishte një nga shkaqet e globalizimit. Globalizimi është bashkim ndërkombëtar i kulturave, shoqërive dhe ekonomisë. Migrimi është një tjetër shkaktar kryesor i multikulturalizmit, ku kemi migrim të detyruar i shkaktuar si pasojë e fatkeqësive natyrore, luftës si dhe migrim në

bazë të zgjedhjes së lirë të individit, të cilët shpresojnë të gjejnë punë në vende të huaja (Wilterdrink 1998).

Amerika ka një popullsi kulturore më racore në botë dhe ky diversitet është rritur vetëm gjatë viteve për shkak të emigracionit që është një tjetër shkak i madh i multikulturalizmit. Kur këta njerëz vijnë në Amerikë ata vijnë së bashku me kulturat e tyre dalluese dhe mënyrat e jetës. Në vitet e fundit shumë njerëz kanë emigruar në SHBA ilegalisht duke çuar në një numër në rritje të emigrantëve të paligjshëm.

Në fushën e politikës ky term ka dy qëllime kryesore: 1. Mbajtja e marrëdhënieve të mira midis pakicave të ndryshme etnike. 2. Definimi i raporteve midis shtetit dhe kolektiviteteve etnike (Semprini 1999:147). Një vend mund të quhet multikulturorë, kur politika e qeverisë synon stimulimin e marrëdhënieve në mes kulturave të ndryshme në një vend. Një vend gjithashtu është multikulturor kur banorët e një vendi respektojnë vlerat e kulturave tjera duke mos i diskriminuar ato. Objektivat e qeverive janë: të drejtat për të pasur dy pasaporta, të drejtat për ndërtimin e objekteve fetare, krijimin e vendeve të punës për pakicat kombëtare si dhe pranimin e shprehive të emigrantëve p.sh. mbulesa.

Dallime që lidhen me multikulturalizmin

Nevojitet një përdorim të drejtë të termave njëkulturrë, shumëkulturrë, multikulturrë, kurse sipas Bugarskit duhet bërë dallim edhe midis: multikulturrës, multikulturalitetit dhe multikulturalizmit. Multikultura është shenja e ndonjë mjedisi; multikulturaliteti paraqet orientimin e përgjithshëm, i cili kujdeset për atë çështje dhe multikulturalizmi paraqet politikën specifike dhe të përpunuar kulturore dhe arsimore për këtë fushë (Bugarski 2002:166). Në këtë mënyrë të gjitha shtetet moderne janë multikulturore, por nuk janë të gjithë multikulturale dhe as multikulturaliste. Gjithashtu me rëndësi është të dallohen në mënyrë sistematike edhe termat multikulturalizëm dhe interkulturalizëm, të cilët ndonjëherë përzihen në mënyrë të paarsyeshme. Pikërisht për këtë, shpesh herë ballafaqohemi me probleme të ndryshme, sidomos kur një grup shoqëror dominon ndaj grupit tjetër shoqëror, për realizimin e interesave të veta politike apo ekonomike. Është fakt, se ata grupe shoqërore nuk posedojnë fuqi dhe kapacitet të njëjtë, megjithatë konfrontimet janë të paevitueshme. Shembull në Kanada, mospajtimet paraqiten për shkak të kufijve të dominimit ekonomik

të shumicës anglofone mbi Kuebekun frankofon (Breton 1980). Për shkak të kësaj, ekzistojnë edhe përpjekjet kryesore separatiste për pavarësi të Kuebekut frankofon, pra aspekti ekonomik, gjegjësisht relacioni eksploatues – i eksploatuar. Logjikë identike është shënuar edhe në Belgjikë (raporti midis flamanëve dhe valonëve), si dhe në Spanjë, ku rritja e nacionalizmit katalonas koincidon me përfshirjen e Katalonisë në rajonet më të zhvilluara evropiane, të cilët i quajnë “Klubet e të pasurve” (Kimlika 1999:63).

Përdorimi vetëm i një gjuhe, si gjuhë zyrtare në një shoqëri multikulturore, sjellë deri tek ajo që pjesëtarët e gjuhës që janë në numër më të vogël, të mos kenë fuqi administrative në strukturat shoqërore ose njëjtë si ata. Të gjitha këto padrejtësi janë të lidhura me gjuhën, e cila për herë është konsideruar si shtyllë në një shoqëri. Sipas një rregulle, gjuhën zyrtare së pari e pranon klasa sunduese, pastaj popullsia qytetare e më pas fshati, dhe atje ku gjuha e nënshtruar kundërvihet paraqitet dygjuhësia (Kalve 1981:100).

Pluralizmi kulturor përballë multikulturalizmit

Duke i krahasuar problemet e lartpërmendura me ato aktuale në Maqedoni, midis dy bashkësive më të mëdha, asaj shqiptare dhe asaj maqedonase, vijmë në disa vlerësime të sakta por edhe në kontradikta. Edhe pse popullata shqiptare prej fillimit iu kundërvu idesë për një gjuhë zyrtare, problemet nuk qëndrojnë në interesat ekonomike ose politike, por në segregacionin dhe sjelljen jotolerante midis kulturave nacionale, gjegjësisht mungesa e pluralizmit kulturor¹.

Pluralizmi kulturor është i njëjtë me multikulturalizmin, mirëpo shikuar nga aspekti historik, pluralizmi kulturor i paraprinë multikulturalizmit. Dallimi është se pluralizmi kulturor paraqet sjelljen e barabartë, toleruese dhe të hapur midis kulturave nacionale, kurse multikulturalizmi i paraqet kulturat të cilët tani më ekzistojnë në nivel subnacional. Andaj, pluralizmi kulturor është problem i vendeve në zhvillim (rasti i Maqedonisë dhe shteteve tjera nga hapësira e ish-Jugosllavisë), kurse shtetet e zhvilluara ba-

Këtë term, i pari e përdori Alen Lok, një nga figurat udhëheqëse të *New Negro Movementa*, i cili ka qenë i drejtuar për afirmimin e letërsisë zezake dhe artit figurativ në SHBA.

llafaqohen me multikulturalizmin (shembulli me Kuebekun në Kanada, Spanjë, Belgjikë) (Semprini 1999:149).

Shkalla e ulët e dallimeve kulturore midis veti, mund ta lehtësojë asimilimin dhe të çojë drejt homogjenizimit dhe formësimit të kulturave të ndërlikuara nacionale, por kjo nuk është gjithmonë kështu. Shpesh në vepër është dukuria që Frojdi e quajti *narcizmi i dallimeve të vogla*, të cilat veprojnë në drejtim të gabuar, duke e theksuar dallimin kulturor në vend të ngjashmërive të kulturave të afërta. Ky është thelbi i dallimeve midis multikulturalizmit segregues dhe integrues? *Multikulturalizmi segregues* në hapësirën ballkanike fillon të dominojë bashkërisht me procesin e krijimit të shteteve nacionale gjatë shek.19, të cilat bazoheshin në njësimin e gjakut dhe tokës. *Multikulturalizmi integrues* e takojmë në ato shtete ku asnjëra prej tyre, nuk ka bazë për të pasur të drejtë ekskluzive ndaj asaj toke, siç është shembulli i Australisë dhe Kanadasë (Pavković 1998:155-170).

Një veprim tjetër mjaft dinamik është edhe *interkulturalizmi*, i cili nënkupton bashkëveprimin e atyre kulturave, duke theksuar barabarësinë e të gjitha kulturave në veprimet e tyre të përbashkëta. Në plan të parë është pasurimi i tyre pa marrë parasysh dallimin e marrëdhënieve shumicë-pakicë.

Përpjekjet për shoqëritë multikulturore

Shumë popuj, që janë pakicë në shtetet shumëgjuhësore, nëpërmjet gjuhës ata shohin ardhmërinë, dhe gjuhën e shohin si armë kundër robërisë së huaj. Nëse në një shtet shumëgjuhësor orvatemi të krijojmë gjuhë të përbashkët, do të vijmë në situata të palakmueshme. Pse? Para së gjithash, ai shtet do të orvatet të garantoj sigurimin e mjeteve për komunikim të gjerë të nacionaliteteve të ndryshme dhe do të mundësoj të gjithë të integrohen në jetën shoqërore. Por, për ata që kjo gjuhë është e huaj do të jenë të detyruar ta mësojnë me qëllim që mos t'i keqësojnë kushtet e jetës së tyre qytetare. Duke iu falënderuar përkthimeve nga njëra palë, sidomos këtë e bëjnë pakicat edhe pala tjetër do të ketë njohuri për ndonjë kulturë të caktuar. Por kjo formë e demokratizimit e bën më pak të mundur përdorimin e gjuhës së përbashkët, sepse çdokush e favorizon gjuhën e tij. Si kompromis për këtë duhet të përdoren të dyja gjuhët, dhe të kategorizohen edhe si gjuhë nacionale dhe si gjuhë zyrtare. Edhe pse si rezultat i kësaj zmadhohen veprat me përmbajtje të njëjtë, sidomos në shkencë dhe teknikë, kjo situatë

mund të lind nevojën për gjuhë të përbashkët, që mund të jetë më ekonomike. Kjo mund të ndodh në shtetet e ndryshme me ndonjë gjuhë nacionale, që nuk është zyrtare në atë shtet, kështu ka qenë me latinishten në shek. 18, dhe tash mund të jetë me anglishten si gjuhë e përbashkët. Përparësia e dygjuhëtarëve është se janë të aftë t'i njohin ndryshimet subtile midis kuptimit të dy fjalëve dhe mosmashtimit, sepse ai që njih dy gjuhë nuk mund të mashtrohet nga format joharmonike të fjalëve. Nga kjo aftësi e dyfishtë, dygjuhëtarët paraqiten si dhënës të universales.

Shembulli 1. Nëse kthehemi në të kaluarën, medoemos shtrohet pyetja: *a ishte dhe sa ishte Perandoria Osmane shoqëri multikulturore?*

Edhe pse Austro-Hungaria dhe Turqia, në kohën e tyre quheshin “Terr i popujve” – shikuar nga kjo distancë historike që jemi sot, na paraqiten si shoqëri të matura multikulturore, në krahasim me pasardhësit e tyre – shtetet kombëtare, të cilët të gjithë deri një garonin se si t'i rrudhin dhe shtypin pakicat kombëtare, sidomos nëpërmjet mohimit të së drejtës të përdorimit të gjuhës së pakicës e sidomos traditës kulturore (Semprini 1999:154).

Nëse parimi “*Një shtet për çdo popull, i tërë populli në atë shtet*” pranohej në shek. e 19, nuk do të shkatërrohej asnjë nga perandoritë shumënacionale në Evropë, si (Austro-Hungaria, Perandoria Osmane, ish- Bashkimi Sovjetik, ish-Jugosllavia etj.). Gabimi i tyre ishte se ndaj territoreve të bashkuar përveç dominimit politik, kushtëzuan vetëm një gjuhë zyrtare. Pikërisht ky term, gjuhë zyrtare përbën gjuhën e etnikumit shumicë, pra gjuhën e shtetit. Ky term është i domosdoshëm në shtetet njëgjuhësore ku termi gjuhë zyrtare përputhet me atë nacionale, por në ato shumëgjuhësore, gjuhë zyrtare është një nga gjuhët nacionale. Kështu që gjuhët tjera nacionale që nuk janë zyrtare nuk kanë të drejtë ta përdorin gjuhën e tyre në nivele të ndryshme të shtetit. Pra gjuhë zyrtare, në formë të shkruar është *gjuha e administratës, arsimit, gjyqit, sektorit publik dhe ushtrisë* që me çdo kusht e kontrollon pushteti, kurse për popujt e nënshtruar gjithashtu gjuhët janë flamuj të tyre për ta ruajtur identitetin. Si mjete të fortë dhe të rëndësishëm për integrimin linguistik të pakicave edhe më tutje ngelet shkolla dhe institucionet tjera, si armata, administrata, mjetet e komunikimit, botimet etj.

Shembulli 2: Pas Luftës së Parë Botërore, kur u zmadhua numri i gjuhëve shtetërore në Evropë, e më këtë u plotësuan edhe kërkesat të cilat sollën deri te formimi i shteteve të reja mbi rrënojat e perandorive centriste. Ishim dëshmitarë të përsëritjes së historisë, sepse pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë dhe ish-Bashkimit Sovjetik

numri i shteteve u rrit dukshëm. Në të gjitha këto perandori ose federata ishte përfshirë një gjuhë të përbashkët për tërë shtetin shumëgjuhësor. Kuptohet ato perandori, të gjitha kombeve tjera ua garantonte identitetin dhe integrimin në shoqëri. Por të gjithë ata ishin të detyruar ta mësojnë gjuhën e përbashkët, por të huaj, me qëllim të mos i keqësojnë kushtet të jetës së tyre qytetare. Rezultatet nga kjo janë të njohura. Shkatërrim i këtyre perandorive.

Shembulli 3: Në perandorinë e mëparshme habzburgase për gjuhët e pakicave ekzistonte një tolerancë relative, numëroheshin aq kombe sa edhe gjuhë, ky numërim bëhej sipas asaj se cila ishte gjuha amtare gjatë regjistrimit. Nga ana tjetër Evropa ofronte edhe raste të kundërta. Belgjika arriti të ndërtohet si komb, edhe përpos dallimeve kulturore dhe përplasjeve që dilnin nga kjo, nga ana tjetër karakteri i fort dhe fleksibil të institucioneve federale zvicerane, kontribuuan shumë për krijimin e një shteti të njëjtë për të gjithë zviceranët.

Cila duhet të jetë strategjia politike për kuptimin e gjuhës shumicë me gjuhën e tjetrit, i cili përbën pakicë, këtë më së mirë e shpjegon socialisti bretoniz Emil Mason, i cili thotë: *Këshilla ime është që popullit t'i drejtoheni me gjuhën e vet dhe ai do të jetë në anën tuaj. Nëse nuk veproni kështu, atëherë do të shkoni pas hapave të qeverisë*”, më tutje vazhdon *“Nëse socialistët bretoniz duam që të fitojmë në Bretoni, duhet tu drejtohem vëllezërve fshatarë në gjuhën e tyre, në gjuhën tonë të vjetër, të bukur dhe barbare (Masson 1972:205).*

Konfliktet e Multikulturalizmit

Multikulturalizmi mund të çoj në konflikte një vend ku dominojnë kultura të ndryshme, sepse çdo kulturë ka identitetin, standardet dhe vlerat e veta, jo të gjithë vendasit e një shteti mund të respektojnë vlerat e një kulture, prandaj kjo situatë çon në problem me emigrantët (Geijen 1998). Këto konflikte, në masë të konsiderueshme janë rezultat i kundërthënive dhe çrregullimeve shoqërore-politike në shoqëritë bashkëkohore. Pjesa dërmuese e shteteve dhe shoqërive bashkëkohore janë shoqëri heterogjene, të përziera, që përbëhen prej një kulture multikulturore.

Këto shoqëri, në vetvete përbejnë nacionalitete dhe popuj të ndryshëm, pjesëtarë të religjioneve dhe racave të ndryshme. Po ashtu shoqëritë bashkëkohore paraqesin një laramani të individëve dhe grupeve, në pikëpamje të ndryshme ideore dhe politike. Në rrethana të tilla vijnë mosmarrëveshje dhe kundërthënie në mes

grupeve, asociacioneve, shoqatave dhe individëve. Grupet apo individët përpiqen që t'ia imponojnë sjelljet, qëndrimet, doket, rregullat, botëkuptimet e veta grupit apo individit tjetër. Grupi tjetër, përpiqet t'i kundërshtojë këto imponime. Në këtë mënyrë lindin dukuritë e mostolerancës, paraqitja e urrejtjes dhe konflikteve të hapura. Kjo tendencë vlen veçmas për shoqëritë multinacionale, multikonfesionale dhe multipolitike. Këto konflikte dhe kundërthënie kulturore, vërehen gjatë procesit të migrimit të qytetarëve dhe popujve në relacione të ndryshme, fshat – qytet, migrimi prej shteteve të pazhvilluara në shtete të zhvilluara etj. Multikulturalizmi mund të bjer shumë lehtë në konflikt me vlerat e pranuar si universale në shtetet moderne liberale veçmas me ato të cilat janë të ndërlydhura me të drejtat e njeriut si dhe pjesëmarrjen e drejtë nëpër institucione. Të gjitha shoqëritë janë multikulturore po përskaaj veçorive etnike, në shoqëri ekzistojnë edhe shumë ndarje të tjera siç janë, ndarja në të pasur dhe të varfër, meshkuj dhe femra, me shkollim dhe analfabet, të rinj dhe pleq. Këto grupe kanë qasje të ndryshme ndaj botëkuptimeve dhe vlerave të ndryshme.

Është e pamundur të mohosh se emigracioni i pakontrolluar në të kaluarën ka shkaktuar problem me integrimin në Evropë. Për shembull, shumë pjesëtare të komunitetit emigrues izolohen nga shoqëria, duke u ndjerë të përjashtuar në shumë raste, të marginalizuar, të frikësuar dhe të pasigurt për shkak të mos njohjes së gjuhës. Shpeshherë, këta persona përveç problemeve administrative ndeshen edhe me një varg problemesh që kanë të bëjnë me adaptimin, përshtatjen e tyre në kushtet e reja të jetesës. Kjo gjendje te këta persona shpeshherë nxit konflikte dhe mosmarrëveshje të ndryshme, të cilat reflektohen edhe në sjelljet dhe qëndrimet e tyre. Sipas shkrimit të shtypit aktual në Evropën Perëndimore gjenden rreth 20 milionë të huaj me leje qëndrimi dhe më se 10 milionë të tjerë të cilët qëndrojnë pa leje.

Globalizimi kulturor

Globalizimi i ka përfshirë të gjitha qytetërimet, kulturat dhe shoqëritë. Edhe pse i mbështetur në të ashtuquajturin liberalizim ekonomik, në funksionimin e tregut dhe standardizim, ai, mbi të gjitha, është një proces i llojllojshëm dhe kompleks. Shumëllojshmëria dhe kompleksiteti i globalizimit rrjedhin nga kyçja e qytetërimeve të ndryshme, nga kulturat dhe personat e ndryshëm në rrjedhat globale. Madje, gjithnjë e më shumë qartësohen edhe tipat e

globalizimit ekonomik, të cilat i mbështesin standardizimet e prodhimtarisë dhe këmbimin global kulturor që, nga ana tjetër, mbështesin ndryshimin si dhe ripërcaktimin e identitetit kulturor. Globalizimi kulturor vihet re në perceptimet individuale të botës bashkëkohore dhe funksionale (në rrafshin e vlerave komunikuese dhe të përmbajtjes) e tërësive të ndërlydhura. Globalizimi kulturor rrjedh dhe inicion dy procese: ndryshimin kulturor si dhe ripërcaktimin kulturor. Ndryshimi kulturor krijon hapësirë për emancipimin e të gjitha kulturave dhe ndikon në të ashtuquajturin hierarkizimin e kulturave. Kështu, në një mënyrë apo tjetër, është vënë në mëdyshje koncepti integrues i kulturave kombëtare, në të cilin përfshihet edhe respektimi i të drejtave kulturore (e drejta në respektimin e gjuhës së pakicave, e drejta në përzgjedhjen e kulturës vetjake dhe të përkatësisë, e drejta në përzgjedhjen e besimit fetar etj.).

Edhe individët, edhe shoqëritë mund t'i pranojnë vlerat e ndryshme kulturore në bazë të përcaktimeve vetjake, p.sh., në kornizat e përkatësisë së harkut kulturor europerëndimor mund të dëgjohet muzikë afrikane, të shikohet teatër japonez, ballkanik, shqiptar, kroat apo rumun, apo njerëzit të ushqehen me kuzhinën kineze, të veshin sari indian, dhe kjo, të thuash, askënd mos ta shqetësojë në mënyrë të veçantë. Por, cilat do të jenë përzgjedhjet, qofshin ato më kohëshkurtra apo edhe më kohëgjata, detyrimisht do të ndikojnë në ripërcaktimin e identitetit kulturor të njerëzve. Kështu ripërcaktimi kulturor është, si të thuash, një proces i hapur në të gjitha shoqëritë dhe qytetërimet; në vendet e zhvilluara, më pak të zhvilluara si dhe në ato të pazhvilluara fare.

Globalizimi kulturor dhe shumëllojshmëria kulturore

Proceset e identifikimit kulturor jo rrallë janë të ngarkuara me konflikte irracionale, në veçanti kur kemi të bëjmë me identitetet kulturore të pakicave apo edhe në shoqëritë ku përzgjedhjet individuale të vlerave kulturore bien ndesh me tradicionalizmin kolektiv, pra me ato forca shoqërore, të cilat dëshirojnë të eliminojnë apo t'i shmangen respektimit të të drejtave kulturore.

Edhe pse globalizimi kulturor cenon shumëllojshmërinë dhe rivlerësimin e identitetit kulturor, në rrafshin global sikur fut disa standarde elementare kulturore. Kështu p.sh., lufta kundër analfabetizmit është shndërruar në një standard të veçantë të zhvillimit kulturor, ndërsa në botën bashkëkohore standard

konsiderohen edhe kultura e punës me kompjuter, respektivisht aftësia e komunikimit elektronik në rrjet. Ndërsa, kur të komunikojnë përmes rrjeteve të ndryshme elektronike, apo edhe drejtpërdrejt, përmbajtjet dhe kuptimësitë e një komunikimi të tillë varen përjashtimisht nga përzgjedhjet dhe shqetësimet individuale të secilit prej tyre. Kjo mbase mund të konsiderohet edhe një nga arsyet, për shkak të të cilave globalizimi kulturor nuk mund të barazohet me të ashtuquajturin nocion “uesternizim” (perëndimizim), siç pretendojnë antiglobalistët.

Përfundime

Përkundër dallimeve midis termave *multikulturë*, *multikulturalitet* dhe *multikulturalizëm* njerëzit gjithmonë kanë qenë të prirur të komunikojnë përtej kufijve gjuhësorë dhe kulturorë. Kjo është dëshmuar përgjatë historisë në bashkësi të ndryshme njerëzore. Lindja e këtyre termave bëhet me dallime shumë të vogla kuptimore midis tyre, sepse disa nga këta terma *nuk e pasqyrojnë sa duhet shoqërinë tonë, ndaj edhe sinonimet që lidhen me këtë çështje ndihet nevoja t'i precizojnë më mirë kufijtë gjuhësorë dhe kulturorë të një shoqërie.*

Multikulturalizmi nuk do të jetë i kufizuar vetëm në thënie deklarative të ekzistimit të më shumë kulturave brenda një shoqërie. Ai këtyre kulturave do t'u japë fuqi të njëjtë, në të gjitha fushat e rregullimit shoqëror. Pikërisht për këtë, shpeshherë ballafaqohemi me probleme të ndryshme, sidomos kur një grup shoqëror për realizimin e interesave të veta politike apo ekonomike dominon mbi grupin tjetër.

Globalizimi nuk e imponon ekskluzivitetin, apo siç i themi ne, përjashtueshmërinë kulturore dhe civilizuese e as që mund ta pranojë dhe mbështesë konceptin e një bote unike dhe të vetme. Pavarësisht globalizimit të standardeve kulturore, bota jonë kulturore do të ngelë përjetësisht e ndryshme dhe gjithmonë e shënjuar me perceptimet e vlerave kulturore. Njerëzimi sot jeton me botë paralele dhe kulturore, të cilat mund të jenë të ndërlidhura vetëm me anë të komunikimit dhe të informacionit, gjegjësisht me dijen mbi vlerat e tyre të veçanta. Andaj, problemi i globalizimit si proces botëror mund të shihet edhe si proces pozitiv, për shkak se mund të ndihmojë në zhvillimin e shteteve të pazhvilluara. Kjo hap pyetjen e zhvillimit dhe rëndësinë e gjuhëve nacionale, sidomos të popujve të vegjël evropian.

LITERATURA

- АЖЕЖ, Клод (1997). Душата на јазикот. Скопје.
- BUGARSKI, Ranko (2002). *Nova lica jezika*. Beograd.
- BUGARSKI, Ranko. (1997a). *Jezici*. Beograd: Ćigoja štampa. [XX vek]
- ЦБЕТАНОВА Ганка (2007) *Културните разлики и општествената интеграција: Македонија пред и порамковниот договор*. Скопје 2007.
- CASTELLAS, Manuel (1997). *European Cities, the informational society and global economy*, in: An Gray and Jim McGuigan, "Studying Culture (An Introductory Reader)", Arnold.
- CASTELLAS, Manuel (1997) *European Cities, the informational society and global economy*, in: An Gray and Jim McGuigan, "Studying Culture (An Introductory Reader)", Arnold.
- CEL (1996). *Cambridge Encyclopedia of Language*. Cambridge: Cambridge University Press.
- CORSON, D. (1990). *Language Policy across the Curriculum*, Clevedon.
- CRYSTAL, David. (1997). *English as a Global Language*. Cambridge: Cambridge University press.
- DEFENDERS... (2000). "Defenders of Diversity". *UNESCO Courier* 53/4:30-32.
- DOMENAK, Žan – Mari (1991). *Evropa: kulturni izazvo*. Beograd: Bibliotek XX vek.
- FISHMAN, A. Joshua, ur. (1968). *Reading in the Sociology of Language*. The Hague: Mouton De Gruyer.
- FISHMAN, A. Joshua. (2000). "English: 'The Killer Language? Or a Passing Phase?'"'. *Whole Earth*, Spring.
- FISHMAN, J. (1978), *Sociologija jezika. Interdisciplinarni društvenonaučni pristup jeziku u društvu*. Sarajevo: Svjetlost.
- GAJIĆ, Radoslav. (1980). *Živi jezik*. Niš: Gradina.
- GRADDOL, David. (1997). *The Future of English*. London: The British Council.
- GRBIĆ, Jadranka. (2004). *Jezični procesi, identitet i globalizacija*. Në Narodna umjetnost, 41/2. Zagreb.

- HARLOW, J. Donald. (2003). *How to Build a Language*. <http://www.donh.best.vwh.net>.
- IBRAHIMI, Mustafa (2018). *Sociolinguistika*. UNT: Shkup.
- JANTON, P. (1973). *L'esperanto*. Paris.
- KALVE, Luj –Žan (1981). *Lingvistika i kolonijalizam*. Beograd.
- KALVE, Luj –Žan (1995). *Rat među jezicima*. Beograd.
- KIMLIKA, Vil *Etnički odnosi i zapadna politicka teorija*, Habitus, Novi Sad, broj 1/1999, str.63.
- MAFFI, Luisa. 2002. "Endangered languages, endangered knowledge". *International Social Science Journal* 54/173:385-393.
- MASSON, Emile (1972). *Les Bretons et le socialisme*, Paris.
- MAURAS, Jacques. (2004). "Towards a new linguistic world order". U *Languages in a Globalising World*. J. Maurais i M. A. Morris, ur. Cambridge: Cambridge University Press, 13-36.
- MILARDOVIĆ, A. (1998.): *Poraz Europe*, Pan Liber, Osijek-Zagreb-Split, pp. 271.
- MILARDOVIĆ, A. (1999.): *Globalizacija*, Pan Liber, Osijek-Zagreb-Split.
- MÜHLHÄUSLER, Peter. (1994). "Babel revisited". *UNESCO Courier* 47/2:16-21.
- PAVKOVIĆ, Aleksandar (1998). *Multikulturalizam kao uvod u rasparčavanje države: slučaj Jugoslavija*, Sociološki pregled broj 2.
- RALOFF, Janet. (1995). "Languishing languages: Cultures at risk". *Science News* 147/8:117-118.
- RAYMOND, Breton ; Jeffrey G, Reitz and Victor Valentine (1980). *Cultural Boundaries and the Cohesion of Canada*, The Institute for Research on Public Policy, Montreal.
- SEMPRINI, Andrea (1999). *Multikulturalizam*. Clio.
- SHKURTAJ, Gj. & MEMUSHAJ, R. (1998). *Shkolla dhe shqipja letrare*. "Gjuha jonë", nr.1-4/1998, Tiranë, f.56-63.
- SIGUAN M. (2004). *Jezici u Evropi*. Zagreb: Školska knjiga.
- SKUTNAB, B & KANGAS, Tove. (2001). "The Globalisation of (Educational) Language rights". *International Review of Education* 47/3-4:201-219.
- SPEAKING ...(1997). "Speaking in Tongues". *Time Magazine*. July 7:52-58.
- THE WORLD'S... (2001). "The World's linguistic Diversity". *World Watch* 14/3:38-39.



WATSON, Keith. (1999). "Language, power, development and geopolitical Changes: conflicting pressures facing plurilingual societies". *Compare* 29/1:5-22.

WINNERS... (2000). "Winners and Losers".. *UNESCO Courier* 53:4.

UDC _316.482.5(497.7)
Punim studimor

RIZVAN SULEJMANI

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup

Fakulteti i Shkencave Sociale

E-mail: rizvan.sulejmani@unt.edu.mk

ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE NDËRETNIKE – RASTI I MAQEDONISË

РЕШАВАЊЕ НА МЕЃУЕТНИЧКИТЕ КОНФЛИКТИ – СЛУЧАЈ СО МАКЕДОНИЈА

Summary

Which are multiethnic, multireligious, multicultural or have some natural kind of historical, geographical divisions, according to Horowitz known as fragmentized, by nature are conflicting which doesn't mean need to be destructive but could be also constructive, synergic. One of this state is Republic of Macedonia which by its ethnical, cultural and religious population is heterogeneous, and during the all the years of independency had some kind of conflicts which time to time have been violent. After 2001 year, Republic of Macedonia has done serious constitutional changes which made to entered it in the more peaceful political waters but still the public opinion is divided according to the perception about the equal rights and freedom between the Macedonians and Albanians. Today in Macedonia we are not taking only about the political, identical rights but much more about economical and social, which could be the reason for an other conflict. This paper has the intention to analyze the Macedonian case, with the special attention to the Orit Framework Agreement , which is implemented to through the amendments in the

constitution, if it is following two famous theories for conflict management in multiethnic states those of Horowitz and Liphard. The analyses is based on the chronology of political activities starting from the independency of the country and the tendency is to explain if the recommendations of this two theories are implemented. At the end, we will try to give our view, with the suggestions and recommendations on which directions need to follow the processes to avoid the possible conflicts in the future.

Hyrje

Çështja e zgjidhjes së problemeve ndër etnike, si parakusht për eliminimin e konflikteve është aktuale jo vetëm tek ne por më gjerë në regjion dhe botë. Kjo për arsye se globi tokësor tanimë sipas Fridmani është i rrafsh ngase zhvillimi i hovshëm i komunikimit masiv mundësojë qarkullimin e teknologjive, parasë dhe ideve të lëvizë lehtë dhe pa kurrfarë pengesash gjeografike. Sot flasim për një informim total, instant dhe në kohë të çdo njërit dhe çdokujt në tërë globin tokësorë. Kjo mundëson që njerëzit të informuara sa për dallimet kulturore e identitare aq më tepër për nivelin e zhvillimit ekonomik, mirëqenien, liritë dhe të drejtat njerëzore të vendeve dhe shteteve të ndryshme. Për këtë dhe arsye të tjera çdo ditë e më tepër ka lëvizje të njerëzve në kërkim të një jete më të mirë. Studiuesit si Karl D. Detusch, mendojnë se në të ardhmen shtetet nacionale do të jenë nën presion permanent të definohen si shtete multietnike². Sipas një studim të Kombeve të Bashkuara sot mbi 60 milion njerëz janë në lëvizje, janë mobil, qoftë me qëllim të realizimit të ëndrrës së tyre në drejtim të ambienteve ku ata gjykojnë se mund të vinë në shprehje, qoftë si refugjatë apo të ikur nga luftërat. Ky proces që është në vijim dhe pritët të jetë në rritje, krijon përparësitë në dhënien mundësi të një numër të madh talentesh dhe njerëzve ambicioz, që në instancë të fundit shprehte në rritjen e mirëqenies së përgjithshme botërore. Por ka edhe pasoja të mëdha negative në shumë sfera të jetës dhe veçanërisht në perceptimin që krijohet tek disa popuj apo shtete ka gravitojnë këta nomad modern veçanërisht në Evropë e SHBA. Si rezultate i këtyre lëvizjeve kemi ndryshime demografike deri në përmbysje të balancave dhe strukturave ekzistuese etnike e kulturore. Në shtetet që kanë sistem demokratike ku perceptioni i njerëzve është përcaktues në krijimin e opinionit

² Karl D. Deutsch, "Social Mobilization and Political Development", American Political Science Review 55 (Sept 1961): 493-514.

publike, kurse ky është shumë i rëndësishëm për partitë politike krijon një sfidë shtesë si të menaxhohet me te. Disa aktorë politik këtë shqetësim, që sa është real, aq është imagjinarë, perceptcion, mundohen dhe shpesh ja arrin ta vejnë në agjendat e tyre politike që shprehet përmes, urrejtjes, fobisë e cila prodhon mostolerancë që shpie ka fërkimet dhe konflikte ndërkulturore, ndëretnike apo nëdrfetare e racore. Për shkak se spektri i dallimeve që mund të shpien deri tek konfliktet nuk janë vetëm dallimet, kulturore, etnike e religjioze por edhe të natyrave të ndryshme në teori politike shpesh konceptet, shtetet multikulturore, dhe shtetet me dallime racore e religjioze i përmbledhim me një fjalë shtete të fragmentuara. Se sa është i shpërndarë ky fenomen në botë do të përdorim disa të dhëna të Will Kymlicka-s, që sipas tij ka diku 184 shtete të pavarura, ku jetojnë 600 grupe gjuhësore, dhe diku 5,000 grupe etnike. Nga kjo rezulton se raporti ndërmjet shteteve dhe grupeve etnike, është diku 1:27, apo, mesatarisht 27 grupe – etnike jetojnë në një shtet. Sipas Robin Williams, ekzistojnë diku ndërmjet 900 dhe 1,600 grupime më të mëdha në 184 shtetet. Nëse marrim mesataren në këtë parashikim, që është 1250, raporti në këtë rrastë është përafërsisht 1:7 apo mesatarisht 7 grupe etno-kulturore jetojnë në një shtet të vetëm. Një matematikë me këto të dhëna shpjegon se më tepër se gjysma e grupeve etnike (diku 55.7%) – janë pakica që tërësisht jetojnë në një shtet të vetëm. Apo, më tepër se 40% e grupeve më të mëdha etnike janë të shpërndarë në dy e më tepër shtete (Shqiptarët, Kurdët, Baskët, Tamilët, Hungarezët Hebrenjtë, Palestinezët e tj.). Pastaj studimi tregon se mbi 66% e gjitha grupeve etnike janë pakica që nuk përbëjnë më shumë se 10% të popullatës në shtetet ku ata jetojnë. Këto dallime po sipas autorëve janë një nga burimet e konflikteve tek shtete multietnike apo siç i quajtmë të fragmentuara.

Njohësit e mirë të shteteve të fragmentuara apo multietnike si, Will Kymlicka dhe Wayne Norman, japin shembuj se shumë shtete të Evropës edhe sot nuk i përmbajnë tiparet e kombit. Sipas tyre,

“Vihet re se shpesh në listën që përcaktohen tiparet e kombit nuk përfshihen gjitha kushtet. Për shembull, kombet zakonisht kanë gjuhën e përbashkët që i dallon ata nga fqinjët e tyre, por Gjermania dhe Austria janë kombe të ndryshëm që kanë një gjuhë, kurse Zvicranët edhe se në vete ngërthejnë katër gjuhë ndajnë të njëjtin identitet kombëtar.”³

³ Will Kymlicka and Wayne Norman, “Citizenship in Diverse Societies”, (2000), Oxford University Press, New York, pag. 19.

Përskej shembujve ku shtete kombëtare nuk i përmbajnë gjitha karakteristikat e kombit dhe mund të jetojnë në paqe dhe mirëqenie, sfida për një qëndrueshmëri të tillë sot edhe në Evropë paraqet një problem që kërkon zgjidhje. Para se të japim modele për zgjidhjen e kësaj sfide do të numërojmë disa shkaqe që shpien në konflikte ndëretnike.

Shkaqet e konflikteve në shtetet e fragmentuara

F. Fukujama në librin e tij, “Fundit i historisë dhe njeriu i fundit”, flet për fundin e historisë, që sipas tij histori ka kur ka konflikte kurse konflikte ka kur ka pabarazi, andej “çdo shoqëri duhet të pretendoj që ti balancoj sigurinë dhe lirinë”⁴. Ai mendonte se demokracia liberale dhe ekonomia e tregut triumfoj karshi një ideologjie barazimtare siç ishte komunizmi me ekonominë e planifikuar dhe me këtë mbaroj historia në Evropë, por për fat të keq sot jemi dëshmitarë se edhe në këtë kontinent me demokraci liberale çdo ditë e më tepër krijohen parakushte për konflikte të mundshme mbi këto dallime.

Për dallim prej tij, Viloeta Petreska Beshka, vlerëson se konfliktet mund të paraqiten për motive të ndryshme siç janë: një, konflikte për mungesë të resurseve, dy, konflikte për mungesë të plotësimin të nevojave elementare dhe, tre, konflikte për shkak të vlerave të ndryshme që posedojnë grupet e ndryshme të popullatës.⁵

Historiani Zvicran, Urs Altermat, në librin e tij “Etnocentrizmi në Evropë”, flet për fenomenin dhe analizon më tepër shtete të këtij kontinenti si Zvicrën, Belgjikën, Irlandën dhe konstaton se shoqëritë e fragmentuar janë lehtë të lëndueshëm mu për shkak të përbërjes së tyre heterogjene. Pastaj ai vlerëson se në rastin e Zvicrës ajo që e ka mbajtur stabil këtë shtet është fakti se, “raportet në mes të gjuhëve që përdoren ka mbetur përafërsisht i njëjtë”⁶

Por a janë vetëm këto që u numëruan shkak për konflikte në shtetet e fragmentuara? Gjithsesi se jo. Ekzistojnë edhe shumë shkaqe të tjera por për rastin ton të studimit ne do të ndalemi, në ato që i sqaron Donald Horowitz në librin e tij, “Ethnic Groups in conflict”⁷, dhe mbi këto do të japim disa sqarime dhe më vonë edhe

⁴ Fransis Fukujama (1994) „Krajot na istorijata i posledniot ~ovek”, Kultura Skopje, str. 463.

⁵ Viloeta Petreska Beshka, „Konflikti, {to prestavuvaaat i kako se razre{uvaaat”, (1995), Filozofski Fakultet, Skopje.

⁶ Urs Altermat, (2002), “Etnonacionalizmi ne Europe”, Phoenix, Tirane.

⁷ Donald L. Horowitz,(2000), “Ethnic Groups in Conflict”, second edition, University of California Press, page 95-140.

propozime për tejkalimin, apo më mire thënë menaxhimin me konflikte me theks në rastin e R. Maqedonisë.

Spasm Horowitz, ekzistojnë së paku këto tre burime që shpjen deri tek konfliktet në shtetet multietnike:

1. Konfliktet për shkak të kontekstit të modernizimit,
2. Konfliktet për interesa ekonomike,
3. Konfliktet për shkak të dallimeve kulturore

Para se të kalojmë në format e menaxhimit të konfliktit kalimthi vetëm do të cekim se konfliktet jo detyrimisht janë destrutiv dhe të dhunshëm. Isak Adizhez që merret me zgjidhjen e konflikteve në sektorin privat por edhe në atë publik vlerëson se rruga ka destruktiviteti i çdo konflikti është e çelë dhe e drejtë. Që do të thotë, nuk duhet të ndërmerret asgjë veprim shtesë që një konflikt të kaloj në destrucion por edhe në dhunë. Që një konflikt që ti shmanget zonës së rrezikut duke mbetur në këtë rrugë pa kthim dhe të transferohet nga destrutiv në konstrutiv apo, sinenergjik, duhet marrë disa veprime për të cilët do flasim më poshtë.

Por pik së pari do të japim një definicion për atë çka llogaritet për konflikt destrutiv shikuar nga një këndvështrim ekonomik matematikorë. Sipas kësaj qasjeje, konflikti është destrutiv atëherë kur „caku është të arrihet qëllimi dhe në të njëjtën kohë të neutralizohet, dëmtohet, apo, eliminohet kundërshtari „. Kurse që një konflikt të transferohet në sinenergjik për të cilin nuk do të flasim në këtë rast por vetëm do të potencojmë se ajo do të thotë të kemi konflikt konstrutiv⁸.

Duke mos u ndalë më andej në këtë problematik, ne do të kalojmë në formulën apo taksometrinë e menaxhimit me konflikte në shtete multietnike dhënë sipas John Mc Garry, Brendan O’Leary and Ben Reilly.

⁸ Një përshkrim më adekuat I kuptimit të sinenergjisë shprehet përmes formulës, $2 + 2 \neq 4$, por $2+2 \geq 4$, gjegjësisht energjia e liruar nga subjektet që marrin pjesë në konflikt nuk është baras me shumën e pjesë marrësve por ajo më e madhe, apo në shembullin tonë dy plus dy nuk është katër por më e madhe që do të thotë mund të jetë edhe gjashtë edhe shtatë edhe...

Taksometria e menaxhimit makro-politik të konflikteve ndëretnike

Sipas autorëve John Mc Garry, Brendan O'Leary and Ben Reilly, ekzistojnë dy mënyra për menaxhim me konflikte. Njëra që njihet si Metoda e eliminimit të konfliktit, ku bëjnë pjesë; Gjenocidi, Dëbimi me forcë i popullatës, Ndarja apo recesioni i një shteti dhe, Asimilimi. Në historinë më të re të regjionit gjithë këto forma i kemi parë. Për shembull gjenocidi si formë e eliminimit të konfliktit erdhi në shprehje në kohën e konfliktit të fundit në Bosnje kur Millosheviqi bëri gjenocid me qëllim eliminimin e tërësishëm, apo pjesërisht të popullit boshnjak me qëllim që ti reduktoj deri në një numër të kontrollueshëm banorësh. I njëjti politikanë, u përpoq të zbatoj metodën e dëbimit të popullatës në Kosovë, kur me forcë largoj mbi 700.000 shqiptarë nga Kosova. Ndarje me qëllim parandalimin e konfliktit apo edhe eliminimin e tij u ndërмор në federatën e dikurshme që njihej si Çeko-Slllovaqi me ndarjen në Çeki dhe Slllovaqi pas rënies së komunizmit dhe vendosjen e demokracisë liberale si sistem politik. Asimilimi mund të përshkruhet me Shtete e Bashkuara të Amerikës i njohur si melting pot (kazani i shkrirjes) ku të gjithë njerëzit pa marrë parasysh origjinën e tyre etnike apo kulturore pas shkuarjes atje mbarojnë si amerikan, dhe pranojnë një kulturë anglo-saksone. Raste të tilla kanë ndodh edhe në shumë shtet tjera përfshi edhe shqiptarët myslimanë të dëbuar me forcë në Turqi ku pas një kohe kanë mbaruar si turq, shqiptarët katolik në Kroaci por edhe shqiptarët ortodoks në Maqedoni që janë shkri dhe asimiluar në maqedonas e serb.

Metoda e dytë njihet si metodë e menaxhimit me konflikte, ku bëjnë pjesë, Kontroll hegjemone, Autonomi territoriale, Autonomi jo-territoriale, Integrim multikulturorë. Nëse pak më me kujdes i analizojmë politikat e partive politike lehtë do të konstatojmë se gjitha këto metoda me dallime të vogla janë sprovuar apo zbatuar në Republikën e Maqedonisë. Koha e sundimit të VMRO-DPMNE-së në kohën e Gruevskit si kryeministër dhe veçanërisht në kohën e Lubço Georgievskit para nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në vitin 2001 mund të definohet si tendencë për kontroll hegjemone e popullit maqedonas mbi komunitetet më të vogla në Maqedoni përfshi edhe ndaj shqiptarëve. Megjithatë, duhet cekur se me vet faktin se shqiptarët kanë participuar në qeveri gjatë tërë kohës prej pavarësisë së shpallur në vitin 1991 dhe në disa institucione, sado që jo në numër adekuat, elemente të ndarjes së pushteteve si traditë ka pasur. Pati një përpjekje nga partia a parë politike shqiptare, Partia

për Prosperitet Demokratik (PPD) për një alternative të raporteve ndëretnike në Maqedoni përmes një autonomie territoriale politike⁹. Por këtë parlamenti i Republikës së Maqedonisë e shpalli për të pavlefshëm me arsyetim se ishte antikushtetues dhe antiligjorë. Një model i autonomisë jo territoriale por shumë më tepër i demokracisë kosociale apo power shering është Marrëveshja Kornizë e Ohrit e vitit 2001, të cilën e promovon dhe mbron Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) për të cilën Florian Bieber thotë se,

“Marrëveshja Kornizë e Ohrit e transformoj Maqedoninë nga një shtet i vetë shpallur nacional me një koalicion të gjerë jo formal në një shtet që qëndron ndërmjet, shtetit nacional dhe bi-nacional, shtet qytetarë dhe bi-nacional me struktura formale të power-shering-ut¹⁰”

Së fundi promovohet ideja , “një shoqëri për të gjithë”, nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM) e udhëhequr nga Zoran Zaev, për të cilën nuk kemi shumë të dhëna empirike se çfarë do të prodhoj, pasi ai është në pushtet vetëm diku një vit e gjysmë por duket të jetë një model i Integritimit multikulturorë. Ky model për momentin mban një situatë më të relaksuar të raporteve ndëretnike por nuk ka garanci se kështu edhe do të mbetet në të ardhmen. Prandaj ne do të mundohemi të japim modelin e menaxhimit me konflikte në rastin e Maqedonisë shikuar sipas dy mendimtarëve, Donald Horowitz, mbi parimin e Interaksioni ndëretnik dhe të Arend Liphard, mbi parimin e power-shering apo demokracisë konsociale

Menaxhimi me konflikte sipas Horowitz dhe Liphard, në rastin e Maqedonisë

Para se të kalojmë në shpjegimin e këtyre dy teorive do të japim një shikim të Isak Adises një menaxher që merret me menaxhimin e konflikteve si rezultat i ndryshimeve në sektorin privat, që vlerësojmë se në një segment mund të përdoret edhe për konfliktet në sferën publike. Sipas tij çdo konflikt rrugën e ka të drejtë ka destruksioni, dhe nuk ka nevojë të shpenzohet kurrfarë energjie shtesë që ajo të ndodhë. Por që një konflikt ti shmanget këtij destruksioni nevojitet të bëhet një shmangie që kërkon disa parakushte dhe veprime. Në këtë rast nga Adisez neve marrim vetëm se si duket rruga ka destruksioni dhe kthesa që duhet bërë, por për

⁹ Ata organizuan referendumin për Autonomi Teritoriale politike në 11-12 janar 1992, me pyetjen “A jeni për autonomi teritorijalo politike në Maqedoni?”.


¹⁰ Florian Bieber, “Power Sharing and the Implementation of the Ohrid Framework Agreement”, (2008?), IPIKS, Shkup

veprimet e nevojshme në rastin e menaxhimit me konfliktet ndëretnike shfrytëzojmë disa parakushte që shtron Horowitz. Skema më poshtë paraqet dy rrugët e mundshme ka mund të lëviz një konflikt sipas Isak Adizes dhe shkurtesat për veprimet që duhet ndërmarr sipas Horowitz-ite për menaxhim me konfliktet ndëretnike.

Rruga e konfliktit destruktiv dhe shmangja nga ai duke bërë kthesë përmes disa veprimeve¹¹.

Në këtë rast me “D” –në, nënkuptohet distribuimi i të mirave

Kthesa e besimit (Isak Adizes)



materiale dhe financiare, me, “S”-ja, nënkupton struktura e rregullimit shtetërorë, “DP”- dinamika politike që fitohet nga modeli zgjedhorë dhe “KP”, kultura politike e bashkësive etnike që jetojnë në një shtet multi-etnik.

D- Distribuimi i mjeteve materiale dhe financiare përfshinë, 1. Politika të shpërndarjes adekuatë të mjeteve materiale dhe financiare, 2. Politika e ndarjes së tregut të punës, 3. Politika e konkurrencës në biznes sipas vijave etnike dhe 4. Konkurrenca e klasës punëtore. Këto çështje në rastin e Maqedonisë nuk janë adresuar në mënyrë eksplicite me MKO. Ekziston një disbalancë tejet i theksuar sa si pasojë e padrejtësive historike aq edhe I politikeve të gabuara¹², në moment edhe qëllimkeqë siç ishte rasti

¹¹ Skema e rrugës është marë prej librit të Isak Adizes, “Menaxhimi me konflikte” kurse veprime e nevojshme janë shfrytëzuar nga libri i, Donald L. Horowitz,(2000), “Ethnic Groups in Conflict”, second edition, University of California Press

¹² Slavko Milosavljević, Mirce Tomovski (1970), “The Albanians in the Republic of Macedonia 1945-1995 Legislation – Political Documentation - Statistics”, NIP Studentski Zbor, Skopje page: 329

me denacionalizimin e pronës shoqërore por edhe asaj shtetërore pas rrënimit të sistemit komunist, kur u aprovua model për decentralizim që i përjashtonte shqiptarët nga participimi në ndarjen e kësaj prone.


Por ka disbalancë serioz edhe sa i përket qasjes në tregun e punës dhe ndarjes së të mirave publike për më tepër arsye por një nga më të theksuarat është ndërprerja e arsimit në gjuhën shqipe në vitet nëntëdhjeta që ka krijuar një boshllëk serioz tek shqiptarët që sot janë në vitet e dyzetat dhe pesëdhjeta, që njihen si vite më produktive, veçanërisht në profesionet më profitabile siç janë ato inxhinerike¹³. Këto padrejtësi historike edhe sot e kësaj dite kanë pasoja si në konkurrencën e tregut të punës në baza etnike por edhe në atë të biznesit.

S - Struktura e organizimit shtetërorë, siç u cek në Maqedonia që nga pavarësia janë provuar disa modele si atij etnocentrik maqedonas që mund të numërohet Kontroll homogjene e kësaj popullate mbi komunitetet tjera, deri tek modeli post MKO, si demokracia konsociale apo power shering, deri tek koncepti më i ri që promovohet nga Zoran Zaev për një shoqëri të përbashkët që mund të shihet si koncept i Integrimi multikulturorë. Në këtë hark kohorë kuptohet se kishte situata të tensionuara deri tek një konflikt i dhunshëm ndëretnik që ndodhi në vitin 2001 që ishte si rezultat i konceptit etnocentrik apo kontroll hegjemone që promovohet në zgjedhjen e problemeve ndëretnike. Pas MKO Maqedonia filloj një stabilitet serioz por pati një polarizimi të skenës politike mbi baza etnike që mbante situata të tensionuar por të kontrolluar. Forma më e shprehur e tensioneve ndëretnike ishte ajo e ngjarjeve të viti 2015 i njohur si rasti i Kumanovës kur pati një përplasje serioze të forcave të sigurisë me një grup të armatosur shqiptarë edhe se politika zyrtare i kualifikoj si grup terrorist ata, kurë nuk e pranuan këtë kualifikim as në gjyq as në paraqitjet publike ngase veten e shihnin si mbrojtës të të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni. Pas kësaj erdhi deri tek ndërrimi i pushtetit nën moton një shoqëri për të gjithë kur për së pari herë një numër serioz i votuesve shqiptarë votuan një parti politike maqedonase siç ishte LSDM-ja e Zoran Zaevit. Për momentin ka një relaksim të marrëdhënieve ndëretnike por nuk mund të nxirren konstatime të bazuara në fakte empirike pasi perioda është e shkurtër, ngase qeveri u formua më 31 maj të vitit 2017.


¹³ Më tepër për këto disparitetet shih R. Sulejmani, "Vizioni"....!!

DP-Dinamika politike, bazuar në sistemin zgjedhorë është një parakusht që mund të ndikoj në menaxhimin e raporteve ndëretnike në një shtet të fragmentuar sipas D.L. Horwitz. Sipas autorit modelet zgjedhore mund të kenë ndikim nëse do të rriten apo zvogëlohen

Parti jo etnike



Parti bazuara mbi baza etnike



Forcat centripetale

Forca centrifugale

forcat centripetale dhe centrifugale siç shihet nga skema në vazhdim.

Marun nga: Donald L. Horwitz,(2000), “Ethnic Groups in Conflict”, second edition, University of California Press, page147

Në rastin e R. Maqedonisë ka pasur disa modele zgjedhore nga ai i shumicës, ku Maqedonia ishte e ndarë në 120 njësi zgjedhore për çdo deputet një njësi zgjedhore, i kombinuar ku 80 deputet zgjidheshin sipas sistemit të shumicës kurse 40 sipas atij proporcional deri tek ky i fundit proporcional me 6 njësi zgjedhore ku mandatet ndahen sipas të ashtuquajturit model i Dontit. Por deri në zgjedhjet fundit të vitit 2016 partitë politike në princip organizoheshin mbi baza etnike me përjashtime të vogla. Kjo situatë mbante taborët etnike homogjene dhe krijonte tensione ndëretnike të kohë pas kohshme. Për së pari herë në zgjidhjet e fundit parlamentare, mbi këtë model erdhi deri tek derdhja e një numri më të madh të shqiptarëve në një parti politike maqedonase por jo edhe e kundërta, maqedonas të votojnë parti politike shqiptare¹⁴. Për së pari herë në zgjedhjet e fundit lokale pati koalicion parazgjedhorë,

¹⁴ Në këtë rast me parti politike maqedonase apo shqiptare nënkuptojmë, ata që udhëhiqen nga lider maqedonas, gjegjësisht shqiptarë dhe pjesa dërmuese e anëtarëve dhe votuesve janë të komunitetit që i takon lideri. Kjo nuk nënkupton se partitë politike janë shpallur për të mbyllura karshi komuniteteve tjera por realiteti ka qenë i tillë.

apo kandidat të përbashkët për kryetarë komune të një partie politike maqedonase dhe një partie politike shqiptare, BDI-LSDM.

KS- Kultura strategjike, shikuar në përvojën e gjertanishme të skenës politike të Maqedonisë nuk dallon shumë mbi baza nacionale përveç një çështje siç janë integrimet euro-atlantike. Rreth kësaj çështje ekziston një dallim në prioritete edhe se ka një konsensus sa etnik aq social e religjioz sa i përket orientimit pro perëndimor të vendit dhe anëtarësimit në NATO. Por në procesin e prioretizimit ka dallime që shpesh krijojnë edhe fërkime por edhe tensione ndëretnike. Përderisa shqiptarët janë në gjendje të sakrifikojnë, apo lënë në plane të dytë interesin etnik për llogari të integriteteve evropiane dhe evro-atlantike maqedonasit deri në zgjidhjet e fundit, por edhe tani, së paku opinion publik i tyre por edhe parti politike preferon interesin etnik, apo identitetin para integriteteve evropiane. Për momentin zhvillohen proceset e ndryshimeve kushtetute bazuar mbi të ashtuquajturës Marrëveshje e Prespës ndërmjet Republikës së Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë, për ndërrimin e emrit e kësaj të fundit në Republika Maqedonia e Veriut, që u nënshkrua më 17 qershor 2018 ndërmjet dy ministrave të punëve të jashtëm Nikos Kocijas dhe Nikola Dimitrov në prezencë dhe përkrahje të fuqishme të kryeministrave Aleksis Cipras dhe Zoran Zaev, por kryetari i shtetit aktual Gjorgje Ivanov refuzon të nënshkruaj këtë marrëveshje edhe se është ratifikuar në parlament dhe shpalljen e rezultateve të referendumit për këtë marrëveshje. Në këtë rast duhet cekur se në koalicionin ekzistues një nga kërkesat e shqiptarëve ishte aprovimi i një ligji me të cilin gjuha shqipe do të fitonte një hapësirë më të madhe për përdorim zyrtarë edhe ky ligj nuk nënshkruhet nga kryetari i shtetit që të mund të shpallet në gazetën zyrtare që të mund të hyjë në fuqi. Përskaj se partitë politike kishin një marrëveshje me të cilën ky ligj duhej të hyjë në fuqi në 100 ditët a e para të qeverisjes, ata nuk insistojnë në këtë në emër se prioritet janë integrimet andej ai sikur është lënë në haresë.

Menaxhimi me konflikte sipas teorisë së Arend Liphard, që njihet si power-sharing apo demokracia konsociale në rastin e Maqedonisë gjen zbatim serioz edhe si praktikë edhe si normë kushtetuese. Nëse si parakushte për funksionimin e kësaj teorie njihen: 1. Vijat etnike qartë të ndara, 2. Shteti i vogël dhe 3. Elitat politike të njihen, në rastin e Maqedonisë duket se plotësohen këto parakushte¹⁵. Sipas këtij mendimtari, që të mundet një shtet multietnik të shmang

¹⁵ Arend Libhard, "Democracy in plural societies", Skopje, 1994, pg 59-101

konfliktet apo, të menaxhoj suksesshëm me te, duhet që si praktik pse jo edhe akti më i lartë juridik, kushtetuta të garantojë që: 1. Të ketë, qeveri e koalicionit të gjerë, 2. Të ketë mundësi për veto e ndërsjellë apo, mbrojtja e interesave vitale të pakicave, 3. Të zbatohet proporcioni si masë kryesore për matjen e përfaqësimit politik dhe 4. Të ketë një shkallë lartë të vetëqeverisjeje të segmenteve në zgjidhjen e problemeve të brendshme¹⁶.

Nëse analizohen me kujdes si parimet bazë por edhe shtojcat e MKO, R. Maqedonisë pas ndryshimeve kushtetuese përmban mjaftë elemente të kësaj teorie të adaptuara për rrethanat ekzistuese. Pik së pari ky vend ka një traditë të qeverive të zgjeruara edhe para vitit 2001 me që në pushtet marrin pjesë gati gjithë segmentet e shoqërisë por me marrëveshjen kjo praktikë përforcohet dhe fiton në peshë. Veto në pushtetin ekzekutiv nuk parashihet por në pushtetin legjislativ parashihet një votim i dyfishtë për ligjet që tanojnë marrëdhëniet ndëretnike dhe për zgjedhjen e disa funksionarëve si Avokati i Popullit, anëtarëve në Gjyqin Kushtetues. Ekziston edhe një trup i njohur si Komiteti për marrëdhënie ndëretnike pranë parlamentit që vlerëson se cilat ligje dhe vendime nevojitet të votohen me dy shumica ku shqiptarët dhe maqedonasit janë të përfaqësuar në paritet 7 anëtarë shqiptarë dhe 7 anëtarë maqedonas kurse 5 anëtarë janë të komuniteteve tjera më të vogla që prezantohen me nga një anëtarë. Sa i përket proporcionit, nuk ekziston si term por ai njihet si “përfaqësim adekuat dhe i drejtë” në organet shtetërore dhe publike që është tanimë normë kushtetuese. Nuk parashihet as autonomia, por ka në decentralizimi serioz ku komunat me shumicë të komuniteteve që nuk është shumicë në nivel shteti gëzojnë të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre si gjuhë zyrtare në nivel lokal dhe përdorimin e simboleve si flamurin e tyre nacional.

Me këto ndryshime përfaqësimi i shqiptarëve dhe komuniteteve tjera në organet shtetërore dhe ato publike dukshëm është rritur sikurse edhe realizimi i përdorimit të gjuhës dhe simboleve të komuniteteve që nuk janë shumicë në nivel lokal por edhe në atë qendrorë siç është parlamenti. Marrëdhëniet ndëretnike dukshëm janë më relaksuara pro dallime serioze edhe më tutje ekzistojnë në gjitha sferat e jetës, veçanërisht në shpërndarjen e pasurisë publike


¹⁶ Саво Климовски, (2000, “Политиката и институциите“, Просветно Дело, Скопје, стр 231: 233.

dhe ato financiare dhe shfrytëzimin e resurseve të përbashkëta shtetërore.

Konkluzione

Republika e Maqedonisë në esencë në organizimin e vet politik i kombinon këto dy teori politike për menaxhim me konfliktet. Ajo sot është shumë afër definicionit të Florian Bieber-t të një shteti që luhet ndërmjet një shtetit nacional dhe bi-nacional me koncept qytetarë me struktura formale të power-sharing-ut..

Koncepti i neutralizimit të konflikteve para dhe pas 2001-it



Përsëri fakti se ka arritur një stabilitet ndëretnik ende ekziston në dallime nëse komunitetet që nuk janë shumicë, veçanërisht shqiptarët, i gëzojnë apo nuk i gëzojnë të drejtat e barabarta në praktikë si në aspekt kushtetues e juridik deri teka ato ekonomike e social. Nëse ka pasur dallime rreth këtij shteti ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve nuk kanë qenë ato nëse ky shtet duhet apo nuk duhet të ekzistoj me përjashtime të vogla që kur nuk kanë marrë ndonjë legjitimitim në zgjedhje, por si duhet rregulluar brenda dhe cili duhet të jetë prioritet në politikën me jashtë. Ka ekzistuar një dallim konceptual se çka duhet të jetë prioritet, apo nga duhet të nisemi që sistemi të stabilizohet. Maqedonasit sikur preferonin sigurinë para lirisë dhe të drejtave për dallim prej shqiptarëve që mendonin se zgjerimi i gamës së lirisë dhe të drejtave individuale dhe kolektive do të sjellë sigurinë e shtetit. Një paraqitje skematike e këtyre qëndrimeve para dhe pas vitit 2001 është dhënë më sipër. Nga skema lehtë mund të konstatohet se ngjarjet e vitit 2001 dhe MKO,

bënë çqëndrosjen e pikëfillimit për stabilizimin e sistemit politik në shtet. Nëse para konfliktit kur botëkuptimi politik “maqedonas”, me përjashtime, që injoronte mendimin politik “shqiptarë”, insistonte në që vend të parë të jetë siguria e shtetit, si parakusht për demokratizim, kurse dihet se; “sa më shumë siguri” të ketë një shtet ajo nënkupton aq më pakë liri, e kjo e fundit është domosdoshme për demokraci, që duhet të sjellë barazinë, ishte e qartë se vendi ishte lagë stabilitetit. Marrëveshja Kornizë e Ohrit, në një mënyrë e çqëndrosi pikëfillimin për stabilizimin e shtetit në pozicionet kushtimishtë ti quaj “shqiptare”, që liria me të drejta individuale e kolektive, mund të krijojë mundësi për barazi e cila do të prodhojë siguri dhe në kushte të tilla të mund të zhvillohet demokracia.

Megjithatë, vlerësimi ynë është nëse që ky shtet dëshiron të jetë stabil në afatgjatë dhe ti mbaj bashkë bashkësitë etnike, veçanërisht shqiptarët dhe maqedonasit i nevojitet që çështjet ndëretnike permanent të trajtohen dhe kultivohen. Gjegjësisht, ati i nevojitet një materie e gjallë, jashtë statikës politike, që ka të bëjë me dinamikën politike, një ngjitës, çimento, paksa me e përbërë. Parimet që shtrojnë Horowitz dhe Liphard krijojnë konturat e një statike politike që R. Maqedonisë në një formë i ka bashkëdizuar në kushtetutën e saj me MKO por ato duhet fisnikëruar. Fisnikërimin e shohim në një ngjitës që për rastin e Maqedonisë e kemi pagëzuar shkurtimisht si, “DEDE”, emër që përbëhet nga shkronjat e para të fjalëve, Demokratizimi, Ekualizimi, Decentralizimi dhe Evropeizmi. Gjegjësisht, çimentoja lidhëse e komuniteteve, “DEDE”, është më tepër një filozofi, kulturë e psikologji, që duhet të kultivohet si shumë e vlerave; Demokratizm + Ekualizim + Decentralizim + Evropeizm¹⁷.

¹⁷ Më tepër për këtë shih në: Rizvan Sulejmani, „Cili është “ngjitësi” që i lidh bashkësitë në R. Maqedonisë multi etnike? “DEDE”-formula e stabiliteti” (2015), UT, Tetovë

Literatura:

- Arent Libhard, "Democracy in plural societies", Skopje, 1994, pg 59-101
- Donald L. Horowitz,(2000), "Ethnic Groups in Conflict", second edition, University of California Press, page 95-140.
- Florian Bieber, "Power Sharing and the Implementation of the Ohrid Framework Agreement", (2008?), IPIKS, Shkup
- Fransis Fukujama (1994) „Krajot na istorijat i posledniot ~ovek”, Kultura Skopje, str. 463.
- Isak Adizs, "Menaxhimi me konflikte"....
- Karl D. Deutsch, "Social Mobilization and Political Development", American Political Science Review 55 (Sept 1961): 493-514.
- Rizvan Sulejmani, "Каква демократија ќе произведе економската нерамноправност во мултиетничка Република Македонија?" "Vizione", International magazine for social scienc,Nr.22, Скопје 2014
- Rizvan Sulejmani, „Cili është "ngjitësi" që i lidh bashkësitë në R. Maqedonisë multi etnike? "DEDE"-formula e stabiliteti" (2015), UT, Tetovë
- Slavko Milosavljevski, Mirce Tomovski (1970), "The Albanians in the Republic of Macedonia 1945-1995 Legislation - Political Documentation - Statistics", NIP Studentski Zbor, Skopje page: 329
- Urs Altermatt, (2002), "Etnonacionalizmi ne Europe", Phoenix, Tirane.
- Violeta Petreska Be{ka, „Konflikti, {to prestavuvaat i kako se razre{uvaat", (1995), Filozofski Fakultet, Skopje.
- Will Kymlicka and Wayne Norman, "Citizenship in Diverse Societies", (2000), Oxford Universitz Press, New Zork, pag. 19.
- Саво Климовски, (20000, "Политиката и институциите", Просфетно Дело, Скопје, стр 231: 233.



UDC 316.723 :821.163.3-31.09
UDC 316.723: 821.18(497.7)-31.09
Punim studimor

AVZI MUSTAFA

Universiteti 'Shën Cirili dhe Metodi
Fakulteti i Filologjisë 'Blazhe Koneski' Shkup, Maqedoni
E-mail: avzimustafa@yahoo.com

**KUFIRI NDËRMJET KULTURAVE TË NDRYSHME, VËSHTRUAR
PËRMES ROMANIT "BALLKANBABILONASIT" TË LUAN
STAROVËS**

**ГРАНИЦАТА ПОМЕЃУ РАЗЛИЧНИТЕ КУЛТУРИ, ГЛЕДАНО
ПРЕКУ ПРИЗМАТА НА РОМАНОТ
„БАЛКАНОБАБИЛОНИЈА„ НА ЛУАН СТАРОВА**

Summary

In different studies, it is indisputably emphasized that cultural boundaries are more sustainable than nationalisms, ethnicities and race, because they are boundaries created by the dispersed collectivity in social systems, which are affected by what we call culture.

In reference to culture, however, we should consider some premises directly related to the definition of some concepts that emerge from The Balkan Babylonians, the novel of our world-famous writer Luan Starova, where we can clearly understand that they have to do with the cultural identity, acculturation, and habitus.

Living among cultures means developing "the perspective of cultural boundaries in terms of pragmatic application, such as rituals and strategies of the way of living and interacting in a new system of affection and thoughts."

Language is one of the most important elements of ethnic identity. Through it, members of the ethnic group understand the values, beliefs, ideologies, and other intangible aspects of culture. It is said that language, as

a means of communication for individuals of social groups, is not considered separated from culture.

The novel "The Balkan Babylonians" by Luan Starova, the focal point of which is the issue of oriental elements, such as Turkish elements in the Albanian and Macedonian vocabulary, defends the thesis that a language without foreign words does not exist and that excessive purism in a language is detrimental, a thesis that was also defended by Faik Konica.

On the one hand living between the boundaries of different cultures means facing challenges and difficulties, but on the other hand it helps you gain a lot of knowledge and it increases cultural capacity. Living among different cultures should not be understood as occurrence of conflictual situations, but as integration, preserving the values of coexistence.

Hyrje

Qëkur e mora ftesën që të marr pjesë në këtë panel, ku temë do të jetë *kultura*, kisha një ndjenjë hezitimi se a duhet t'i përgjigjem kësaj ftese. Asociacioni i parë që më zgjoi tema na fjalë ishte mendimi i lingvistit Williams, i cili thotë se të "flasësh për kulturën është një punë me përgjegjësi".¹⁸

Unë nuk dua që sot para jush të jap përkufizime se ç' nënkuptojmë me nocionet: kulturë, multikulturë, interkulturë, akulturim ose të ndalem në teoritë e ndryshme të sociologëve ose sociolinguistëve të njohur, por do të doja të them diçka për jetën e njerëzve që jetojnë në kufij të kulturave të ndryshme.

Duke mëtuar që të përcaktohem për një shkrimtar të njohur që do të kishte mundur ta tipizojë idenë e kumtesës sime, u përcaktova për shkrimtari tonë të njohur në përmasa botërore, Luan Starovën. Me këtë rast, pa dashur ta luaj rolin e promovuesit, do t'i referohem romanit të tij me titull "Ballkanbabilonasit"¹⁹, një nga romanet e fundit të Starovës që, me të drejtë, është vlerësuar si roman - bibliotekë, roman - oqean, roman - enciklopedi. Bëhet fjalë për një roman shumështrësor që ndalet në temën e Ballkanit dhe raportit Ballkan - Evropë, për roman që trajton një çështje filologjike, siç është tema e purizmit gjuhësor, gjithmonë duke pas parasysh tabanin e labirintit të mentalitetit ballkanik²⁰.

Sigurisht, nuk e ndjej të nevojshme, në këtë rast, të citoj apo parafrazoj vlerësimet e mendimtarëve, kritikëve e shkrimtarëve me

¹⁸ .Williams,R.The Sociology of culture, The University of Cocago, 1995.

¹⁹ Romani "Ballkanobabilonasit" u botua më vitin 2014 nga ASHM dhe u shpall si roman i vitit.

²⁰ Mirlinda Krifca, Studime letrare mbi veprat e Luan Starovës (dorëshkrim)

përmasa botërore për veprën e Luanit, por kësaj shumësie të vlerësimeve, do t'ia kisha shtuar mendimin tim modest se Luan Starova i ka flatrat më të mëdha se ç'e ka folenë. Ai, si gjithë krijuesit e mëdhenj, nuk i takon vetëm atdheut të tij, qoftë ai atdheu i tij i parë ose i dytë, por i takon letërsisë së përbotshme.

Në studimet e ndryshme, jo rastësisht theksohet se kufijtë kulturorë janë më të qëndrueshëm seç pretendon nacionalizmi, etnia e raca, sepse ato janë kufij të krijuar nga kolektiviteti i shpërndarë në sisteme shoqërore, të cilat ndikohen në atë që ne e quajmë kulturë²¹.

Kur bëhet fjalë për kulturën, gjithsesi duhet të ndalemi tek disa premisa, që janë të lidhura drejtpërdrejt me përkufizimin e disa koncepteve që dalin nga romani, siç është identiteti kulturor, akulturimi dhe habitusi.

Siç dihet, identiteti kulturor është një derivat i identiteti shoqëror dhe përkufizohet si gërshetim i kontaktit personal dhe kulturor brenda aksionit shoqëror. Njeriu, si individ, duke jetuar në mesin e kulturave të ndryshme, nuk mund t'i ikë akulturimit, i cili vepron në dy mënyra: së pari, janë ndryshimet kulturore dhe, së dyti, janë ato psikologjike, në rastet kur dy ose më shumë grupe të ndryshme kulturore ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Akulturimi po ashtu është një proces, i cili zgjat dhe zhvillohet për aq kohë, sa dy grupe kulturalisht të ndryshme janë në ndërveprim shoqëror me njëri-tjetrin. Kjo ilustron me fragmentin në vijim: *"E ëmja, Hasbija, shpresonte se familja do të shpërngulet në Turqi, ku ajo kish familjen e saj. Kushëriri i saj i parë Ali Feti Okjar ishte ambasador i Turqisë në Angli. Më 1937, ajo shkoi për punë pasurie në Stamboll dhe pasi u kthye e lodhur, u bind se djemtë e saj nuk do të shkojnë në Stamboll. Ajo gjatë kësaj vizite e kishte pasur të vështirë komunikimin me motrat, meqë ajo fliste në gjuhën osmanishte, kurse ato në gjuhën e re turke, të pastruar me reformat radikale të Atatürkut. Ajo përdorte madje, pa vetëdije, edhe fjalë shqipe."*

Sociologët e përdorin termin "HABITUS" për të nënkuptuar urën midis hapësirës shoqërore dhe kapitalit kulturor. Habitusi përbrendësohet tek individët, jo thjesht vetëm në aspektin e veshjes, të folurit, të ushqyerit, por edhe në kulturën dhe sjelljen. Këtë do ta ilustrim me personazhin kryesor të romanit, *Babain*. Ai një pjesë të shkollimit e ka kryer në gjuhën turke. Lidhjet e tij me kulturën dhe traditën turke, që lidhen me qëndrimin dhe studimet e mbaruara në

²¹ Vasilevski, G. Multiculturalism in Post- Ohrid ,Macedonia, Some Philosophical Reflections, SAGE, Journals Vol. 27 No. 4 2013 p. 687-705.

Starmboll, me librat e shumtë që kishte sjellë nga kryeqendra otomane, nga miqësitë që kish krijuar atje, nuk e shkulën atë një rrënjët e identitetit të tij shqiptar dhe nga gjuha e vendit, nga i cili vinte. Këtë e shohim shumë qartë në këtë fragment: *“Ai kishte pasur fatin që në shtëpinë e dajës së tij, Ali Feti Okjar, të takohet me Ataturkun, babanë e Turqisë së re, i cili i pat thënë se Turqisë i duhen më shumë se kurrë jurist të rinj. Por, Babai duke u gjendur para rubikonit të identitetit të tij shqiptar...’ nuk e pranoi ofertën joshëse”²².*

Kultura përfshin besimin tonë, mënyrën tonë si e perceptojmë rrethin ku gjendemi dhe jetojmë. Në këtë frymë është edhe thënia jonë shqipe *“Sipas vendit bëhet edhe kuvendi”* ose ajo latine *“Në Romë – romak”*.

Në anën tjetër, në këtë kontekst, një term tjetër i rëndësishëm është edhe *difuzioni kulturor*, që nënkupton përhapjen e kulturës nga një grup ose individ në një grup (individ) tjetër. Ky difuzion varet nga vazhdimësia dhe intensiteti i kontaktit kulturor.

Jeta në kulturat e ndryshme

Çdo nënkupton të jetosh ndërmjet dy e më shumë kulturave? Është fare lehtë kur jeton brenda kufijve kulturorë të grupit ku bën pjesë. Kjo do të thotë të trashëgosh ose ta zhvillosh kulturën, gjuhën, fenë e trashëguar, por të jetosh midis kufijve ndërkulturorë, paraqet një situatë kur vetvetiu përballësh me fenomenin e akulturacionit. Jeta mes dy kulturave *paraqet mundësi për gërshetim të elementeve kulturore nga dy sistemet kulturore, se këtejmi ata që jetojnë në mjedis të tilla nuk humbin asgjë, por e rrisin kapitalin e tyre kulturor.*

Ja si e përshkruan shkrimtari ynë këtë në romanin *“Ballkanbabilonasit”*: *“Babai, i cili i kishte studiuar në Turqi shkencat juridike, e kishte mësuar edhe osmanishten edhe turqishten e re të reformuar, por edhe shkencat islame...”*

Jeta e Babait në Maqedoni

Për shkak të denoncimit nga *të vetët* dhe mospajtimit me rrethanat në Shqipërinë e kohës, Babai kishte qenë i detyruar që të emigrojë në Maqedoni. Ai brenda natës u gjend në një mjedis tjetër kulturor që, gjithsesi, i paraqiste vështirësi. Ja si përshkruhet kjo situ-

²² Старова, Луан, *Балканававилонци*, МАНУ, Скопје, 2014.f.10.

atë: *“E kishte të vështirë më vonë ta mësojë maqedonishten, si gjuhë sllave, dhe kjo i pengoi në karrierë. Punoi një kohë të shkurtër si gjykatës komunal në lëndë të delikteve të pylltarisë”.*

Të jetosh midis kulturave, sipas sociologut amerikan J. Vasilevski, nënkupton: *“ta zhvillosh këndvështrimin e kufijve kulturorë në aspektin e aplikimit pragmatik, siç janë ritualet dhe strategjitë e mënyrës së të jetuarit dhe ndërvepruarit në një sistem të ri afeksionesh dhe mendimesh”*²³.

Nën ndikimin e modeleve dominuese kulturore, vetvetiu je i kushtëzuar të krijosh kode të caktuara nënkulturore, siç janë: toleranca, respekti i ndërsjellë, zakonet, mënyra e të jetuarit, të cilat i ndihmojnë këto grupe etnokulturore ta realizojnë procesin e përshtatjes dhe integritit sociokulturor. Ndër to, vend të veçantë zë përshtatja dhe integrimi në kulturën e re. Prandaj, vendosja e komunikimit me ato që nuk i njeh apo nuk të njohin, është e vështirë. Kjo bën, shpesh, që njeriu të mbyllet në botën imagjinare të lirisë së brendshme. Por njeriu është qenie sociale, ai ka nevojë për komunikim, për hapje ndaj të tjerëve, në radhë të parë ndaj fqiu, ndaj njeriut me të cilin ndan hapësirën e njëjtë. Kështu edhe heroi i veprës, Babai, filloi të krijojë miq në mjedisin e ri. Ai kishte nevojë edhe për: *“ një parti pokeri në çardakun e shtëpisë, me miqtë e tij turq Afëz B dhe Mustafa S”.*

*“Luanin me pagesë simbolike, 1 denar për grosh. S’kishin partner të katërt të besuar. Atë e ndërronin dhe e konsideronin si “të huaj”. Nuk ishte nga soji i tyre. Meqë ato vite të pasluftës njeriu mund ta pësonte për një fjalë goje, ata ishin të kujdesshëm në zgjedhjen e partnerit të katërt.”*²⁴.

Fatet, toleranca dhe bashkëjetesa

Babai ishte më tolerant, jeta e kishte bërë të tillë. Ai mendonte se bashkëjetesa e njerëzve nënkupton edhe një lloj bashkëjetese të fondit leksikor. Ai i kishte të zhvilluara të gjithë format e tolerancës, duke filluar nga ajo etnike, gjuhësore, fetare. Kështu, pavarësisht se i takonte besimit islam, Babai respektonte kultet dhe objektet fetare të

²³ Vasilevski, G. Multiculturalism in Post- Ohrid, Macedonia, Some Philosophical Reflections, SAGE, Journals Vol. 27 No. 4 2013 p. 687-705..

²⁴ . Старова, Луан, Балканававилонци, МАНУ, Скопје, 2014., f.15.

tjetrit, siç ishte rasti me Shën Naumin, të cilit i luteshin jo vetëm të krishterët, por edhe myslimanët e dervishët.²⁵

“Njohja e dobët e gjuhës dhe mos anëtarësimi në Parti e shpëtuan nga karriera juridike, që me siguri s`do të mbaronte mirë për një emigrant të dyshimtë shqiptar. Punoj si përkthyes nga osmanishtja në maqedonisht në Institutin e Historisë Nacionale të Republikës së Maqedonisë. Aty gjendeshin sishilet, librat e vjetër nga osmanishtja. Madje, zbulimi i sishileve manastirase (nga shek, XVI-XIX) e shënoi edhe fundin e odiseadës ballkanike të Babait dhe të familjes”.

Në lojën e ardhshme, lojtari i katër, ishte njeriu i librave, Kliment Kamilski, që do të bëhet miku më i mirë i Babait. Ai kishte qenë profesor universitar, por e kishin shpallur informbyroist. Kishte dergjur burgun famëkeq të Goli Otokut. Jetonte për librat dhe me librat. Të gjithë u habitën nga lojtari i ri. Në të vërtetë, ai kishte ardhur për t'i parë librat e Babait dhe për t'i sjellë në dorëshkrim tre libra të osmanishtes. Babai kishte dëgjuar për emrin e tij. Ai, si një ndër të rrallët nga Maqedonia, kishte marrë pjesë në luftën e Spanjës, kishte doktoruar në Paris dhe, pas Luftës së Dytë Botërore, pritej të ketë karrierë të bujshme në Maqedoni. Mund të kishte mbetur në Paris, por i prirë nga sindromi i kthimit, si ai i Babait, që qe kthyer nga Stambolli, edhe ai ishte kthyer. Pra, të dy kishin pasur fat të ngjashëm. Për të dy, pas shanseve të lëshuara të karrierës së tyre, libri ishte i vetmi ngushëllim. Duke pasur parasysh famën dhe shkollimin që kishte, Kamilskit i ishte besuar puna në Institutin e Folklorit, sa mos të mbetej në rrugë (pas kthimit nga Goli Otoku).

Ai pranoi të luajë, edhe pse nuk e dinte mirë lojën – kështu u shpreh në fillim – por lojtarët vërejtën se ai shpejt e mësoi atë. Ai u tregoi se në Paris kishte luajtur me shumë pasion dhe se i kishte premtuar vetes se do ta ruante pasionin tjetër – atë për librat dhe fjalën e kishte mbajtur deri në këtë lojë.

Babai dhe Kamilski, edhe pse u takonin besimeve të ndryshme, kuptoheshin mirë mes vete. Pas kthimit nga burgu, Kamilskit nuk i lejuan të kthehet në katedrën e Pedagogjisë të Fakultetit Filozofik, të cilën vet ai e kishte themeluar, por e emëruan drejtor të Institutit të Folklorit, pastaj e larguan edhe nga ky funksion, por jo edhe nga librat. Të dy miqtë ballkanikë ishin moshatarë, kishin lindur në 1898, dhe, çuditërisht, vdiqën në të njëjtin vit, më 1976.

Labirintet ballkanike

²⁵ Луан, Балканававилонци, МАНУ, Скопје, 2014.f.223-224.

Babai synonte ta kuptojë labirintin e bibliotekës, të librave e – me këtë – edhe të Ballkanit. Ai e kërkonte identitetin e tij, që lidhej me një vend hermetikisht të mbyllur dhe me një popull, të vetmin në Ballkan, që e ruante këngën polifonike me katër zëra.

Të dy, pra ai dhe Kamilski, deshën ta shpëtojnë Ballkanin nga mendjet e ngushta dhe të kufizuara, që e rrezikonin ardhmërinë e fëmijëve të tyre. Babai mendonte se labirinti më i madh, labirinti i labirinteve, veçmas në Ballkan, ishte historia. Ballkani ishte i mallkuar, sepse këtu historia vazhdonte në labirint. Ndërkaq Kamilski shpjegonte se, derisa kishte qëndruar në Francë, Spanjë e Belgjikë, kishte dëgjuar për paragjykimet për Ballkanin, veçmas në fushën e gjuhës, se këtu ka shumë gjuhë, dialekte dhe se bëhet fjalë për zonë, ku mallkimi i Babilonit është i shprehur më shumë se gjithkund.²⁶ Kjo ide do ta largojë Ballkanin nga rrethet linguistike evropiane, që e konceptonin atë si të komplikuar dhe të pa kuptuar.

Kultura e gjuhës

Gjuha është një nga elementët më të rëndësishëm të identitetit etnik. Nëpërmjet saj, anëtarët e grupit etnik i kuptojnë vlerat, besimet, ideologjitë dhe aspektet e tjera të paprekshme të kulturës. Thuhet se gjuha, si mjet komunikimi për individët e grupeve shoqërore, nuk konsiderohet si e ndarë nga kultura.

Nisur nga kjo, ata dy ndërmorën nismën e përbashkët për “Largimin e fjalëve turke” me konotacion negativ nga gjuhët e tyre amtare. Pesë turqizmat e para të rrezikshme, sipas Kamilskit, ishin: *jeniçer*, *kurban*, *bashibozuk*, *zandane* dhe *kodosh*. Ndërkaq, sipas Babait, fjala më e rrezikshme, jo vetëm në Ballkan, por edhe në botë, ishte fjala *jeniçer*.

Fjala e dytë, që u diskutua, qe fjala *kurban*, që përdoret në shumë gjuhë e kultura, por që është veçmas karakteristike për Ballkanin. Sipas Kamilskit, “*Ballkanasit janë të vetëdijshëm se i konsiderojnë si ‘të tjerë’, edhe pse me shekuj e kanë në fatin e njëjtë në të njëjtin kontinent evropian, si hapësirë të popujve që nuk arrijnë të mbijetojnë as si Orient i vërtetë, e as si pjesë e barabartë e Perëndimit. Ata gjithmonë mbesin botë-kurban-kufi, pra përgjithmonë të ndarë*”.²⁷

²⁶ Luan Staraova po aty. f.141

²⁷ Luan Staraova, po aty f. 272.

Në listën e Babait, që përfshinte pesë fjalë jo të rrezikshme ishin fjalët: *ajde, javash, kadi, tabiat dhe millet*. Fjalët *ajde* dhe *javash* e shpjegoi me filozofinë e zopoasterimit, që botën e kupton si pasojë të konfliktit të përhershëm mes së mirës dhe së keqes (Jing dhe Jang).

Ndërkaq fjalët e radhës të Kamilskit ishin: *inat, sevap, atër, ryshfet dhe kallaus*, kurse të Babait ishin: *kurbet, syrgjyn, gajret, tapi, qerpiç dhe çaush*.²⁸

Babai u ndal veçmas në fjalët *kurbet* dhe *syrgjyn*, si forma të ekzilit dhe të qenit në një mes të huaj.

Kalaja si kufi

Derisa *kalaja* për Kamilskin ishte simbol i ndarjes mes njerëzve, për Babain "*... kalaja ishte kufi në ekzilin e tij me familjen*".²⁹

Të dy, në fund, u bindën se nëse e fitojnë betejën e tyre me huazimet osmano-turke, "*do t'i varfërojnë gjuhët e tyre dhe të ardhmen e tyre, si edhe të ardhmen e trashëgimtarëve të vet*".³⁰

Romani "Ballkanbabilonasit" i L. Starovës, që në qendër të vëmendjes e ka çështjen e orientalizmave, gjegjësisht turqizimave në shqip e në maqedonisht, e mbron tezën se gjuhë të pastruar nga fjalët e huaja nuk ka dhe se purizmi i tepruar në gjuhë është i dëmshëm, tezë kjo që e ka mbrojtur edhe Faik Konica.

Në fund do të më lejoni të përfundoj duke iu referuar mendimit të linguistit me origjinë shqiptare, gjegjësisht arbëreshe, Bruni, se gjuhët ruajnë histori dhe qytetërimi. Sigurisht, prania e fjalëve turke në gjuhët ballkanike, si në shqip e maqedonisht, është rezultat i të kaluarës otomane të popujve që flasin këto gjuhë, e kaluar kjo që nuk mund dhe nuk duhet të injorohet.

²⁸ Luan Starava, poa aty, f. 355.

²⁹ Luan Starova, po aty, f. 421

³⁰ .Mirlinda Kifca-Beqiri, Studime letrare mbi Luan Staroven (doreshkrim).

UDC 316.723:316.356.2(=163.3:=18)(497.7)

Punim studimor

GJLYMSER KASAPI

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij"

Fakulteti Pedagogjik "Shën Kliment i Ohrit"

E-mail: kasapi.gj@gmail.com

**DALLIMET DHE NGJASHMËRITË NË KULTURAT E FAMILJEVE
MAQEDONASE DHE SHQIPTARE NË MAQEDONI****РАЗЛИКИТЕ И СЛИЧНОСТИТЕ ВО КУЛТУРИТЕ НА
МАКЕДОНСКИТЕ И АЛБАНСКИТЕ СЕМЕЈСТВА ВО
МАКЕДОНИЈА***Summary*

To speak on the topic of differences and similarities in the culture of Albanian and Macedonian families in Macedonia means to scientifically approach the characteristics and culture themselves of these two different families, which without a doubt are the basic cell of the Macedonian and Albanian societies together in a multi ethnic environment, where also other ethnic groups are coexisting, like: Turkish, Romanian, Bosnian, Serbian and Vlach. The above mentioned concept reflects multiculturalism, multiethnicism and religion coexistence in the multi ethnic Macedonian society. Of course, this is one of the current on going topics, and which reflects the reality in Macedonia, because of this I'll try with my case study to be more concrete with scientific arguments.

Tëflasësh nëtemën dallimet dhe ngjashmëritë në kulturat e familjeve shqiptare dhe maqedonase në Maqedoni do të thotë të qasemi shkencërisht në karakteristikat dhe kulturat e këtyre dy familjeve, të cilat padyshim janë qeliza bazë të shoqërisë maqedonase dhe asaj shqiptare në një shoqëri të përbashkët multi-etnike, ku bashkëjetojnë edhe përkatësi të etniteteve të tjera, si; turke, rome, boshnjake, vllahe, serbe etj.

Kjo që theksova më lartë asocon në multikulturalizmin, multi-etnicizmin dhe bashkëjetesën fetare në shoqërinë multi-etnike maqedonase. Gjithsesi se kjo është njëra nga temat aktuale, që prezanton realitetin ekzistues në Maqedoni, prandaj në këtë rast do mundohem që qasja ime të jetë sa më serioze dhe me argumente shkencore. Para se të japë disa të dhëna mbi dallimet dhe ngjashmëritë në kulturat e familjeve maqedonase dhe shqiptare në Maqedoni, kuptohet se do të përkufizoj familjen si mikrobashkësi biologjike, sociale dhe psikologjike, e cila në zhvillimin dhe organizimin e saj historik respekton rregullat dhe normat ligjore në bazë të Deklaratës së Përgjithshme të Paqes dhe të Drejtave Njerëzore.

Familja ka qenë dhe është objekt interesimi i eksperteve të profileve të ndryshëm, sociologëve, pedagogëve, psikologëve, antropologëve, mjekëve, biologëve, ekonomistëve etj. Parë në aspektin historik, familja është grup dinamik shoqëror që është zhvilluar duke pësuar transformime të mëdha. (Sulejmani M.2005;1).

Sipas Gidionisit, familja është grup njerëzish të bashkuar nga lidhjet fisnore, pjesëtarë të rritur, të përgjegjshëm, të cilët për kujdesen për fëmijët.

George Peter Mardock, një emër i njohur i kësaj fushe, e përkufizon familjen si grup kryesor shoqëror, të cilën e karakterizon vendbanimi i përbashkët, bashkëpunimi ekonomik dhe riprodhimi i llojit njerëzor.

Kur flasim për familjen maqedonase, është me rëndësi të themi se ajo gjithashtu ka pësuar ndryshime gjatë historisë së saj njerëzore, duke u zhvilluar dhe ndikuar nga rrethanat të ndryshme shoqërore, politike, ekonomike, ndryshime sistemesh etj.

DISA KARAKTERISTIKA TË FAMILJES MAQEDONASE

Sipas autorit Matilov, në periudhat e zhvillimit shoqëror, marrëdhëniet në familjet maqedonase janë rregulluar në bazë të traditave zakonore, varësisht nga religjionet dhe qytetet e Maqedonisë, kurse në shoqërinë demokratike ato realizohen në bazë të akteve normative ligjore. Në të gjitha qytetet rreth lumit Vardar, respektivisht ne Veles, Negotinë, Demir Kapi, është karakteristike mbi zotërimi i familjes me premisë tradicionale dhe tendenca dinamike për t'i takuar modelit bashkëkohor të familjes. Kjo karakteristike e familjes maqedonase vazhdon të jetë e pranishme edhe në familjet e rajonit të Strugës, Ohrit, Manastirit, Prilepit dhe Krushevës.

Veçoritë e ngjashme të ruajtjes të traditave dhe zakoneve hasen edhe në familjen maqedonase e cila graviton ne rajonin e Pollogut si dhe në pjesën lindore të Maqedonisë si në Kumanovë, Kratovë, Berovë, Shtip, Radovish, Strumicë dhe në rrethinat e tyre ku gjithashtu në masë të konsiderueshme hasim edhe familje fshatare e cila jo vetëm që merret me prodhimtari bujqësore dhe blegtorale, por e karakterizon edhe ruajtja e traditave kulturore të ngjarjeve të ndryshme familjare, sidomos të atyre ku organizohen gëzime familjare si dhe ngjarjeve mortore.

Familja maqedonase në qytetin e Shkupit karakterizohet me funksionimin bashkëkohor të marrëdhënieve të anëtarëve të saj. Bashkëshortet kane tendencë për të qenë të barabartë duke ecur nga modernizimi i jetës familjare. Zakonisht, Shkupi si kryeqytet tërheq vëmendjen e brezave të rinj nga viset tjera të Maqedonisë sepse e shohin në të sigurinë dhe perspektiven e tyre.

Familja maqedonase posedon edhe vlerën edukative e cila ka të bëjë me:

- tendencën e brezave me të vjetër për të kultivuar tek te rinjtë respektin dhe dashurinë ndaj dallimit te moshave.
- konsideratën ndaj gjinisë femërore, e cila në familjen maqedonase historikisht ka pasur vend të merituar
- përpjekjet për të zhvilluar dhe kultivuar procesin e edukimit dhe atë kulturor të brezave të rinj në mënyra dhe forma sa më origjinale.

- Familja bashkëkohore maqedonase, përgjithësisht jeton në kushte të urbanizuara optimale, ekonomike, sociale, politike, kulturore, psikike që padyshim ndikojnë në avancimin dhe afirmimin e vlerave pozitive kulturore.

ÇFARË E KARAKTERIZON FAMILJEN SHQIPTARE

Në hapësirën gjithëkombëtare, familja shqiptare ka pësuar transformime cilësore sidomos në dekadat e fundit të shekullit të kaluar. Në familjen patriarkale shqiptare me karakteristika të veçanta ka qenë oda e burrave, ku inkuadroheshin edhe djemtë pas moshës 14 vjeçare e ku diskutoheshin çështje të ndryshme si besa, mikpritja, atdhedashuria (Goodman G.2008;17).

Familja tradicionale patriarkale të shqiptarët në Maqedoni, ka qenë e kushtëzuar nga faktorë të shumtë historiko-shoqëror, social dhe kulturor. Në këtë kontekst në periudhën e tranzicionit, familja shqiptare pësoi goditje të rënda eksodi, migrimi, zhvendosje të anëtarëve në vende të ndryshme të Evropës dhe botës për të siguruar ekonominë dhe gjendjen më të mirë sociale të familjes.

Familja shqiptare sot transformohet çdo dite e me shume drejt qytetërimit bashkëkohor dhe evropian. Këtë më së miri e ilustron mendimet dhe shkrimet e akademikut Mark Krasniqi.

Sipas autorit të njohur Riza Brada, të familja shqiptare ruhen këto vlera:

- dëgjohet fjala e të zotit dhe zonjës së shtëpisë, sepse këta dy, si për nga mosha ashtu edhe për nga aftësia, e kanë merituar këtë post;
- zbatohen urdhrat e të zotit dhe të zonjës së shtëpisë lidhur me kryerjen e punëve të dobishme për familjen;
- respektohet dhe nderohet më i vjetri në shenjë të meritave që ka për vazhdimin e lozes familjare;
- respektohet dinjiteti i femrës, në mënyrë të posaçme i gruas, nënës dhe i fëmijës;
- Besa shqiptare kultivohet si atribut themelor kombëtar etj.

Sa i përket kulturave të këtyre dy familjeve, maqedonase dhe shqiptare, do më lejoni, të citoj një pjesë të shkurtër nga parathënia e librit tim, me temë të ngjashme, botuar në v. 2013 („Заедничкото, различноста и посебноста низ културните вредности во македонското и албанското семејство“, Касапи Ѓ.,2013 г.)

“Është i nevojshëm debati i shumë popujve dhe i shumë kulturave, për ta arritur përgjigjen e pyetjeve me karakter shekullor, që I parashtron shqetësimi njerëzor. Ne nuk jemi akoma të vetëdijshëm për rëndësinë e komunikimit multikulturor, që ka rëndësi të veçantë, jo vetëm në kuptimin nacional por edhe në atë botëror. Të refuzohet biseda, debate me një kulturë tjetër, do të thotë të refuzohet mundësia për t’u kuptuar diçka e re, për t’u pasuruar kultura personale. Ai që i çmon vetëm vlerat e kulturës së vet, është i verbër për të gjitha kulturat e tjera. Ai është njeri vetëm me një kulturë dhe i dënuar që asnjëherë të mos rritet dhe përparojë. Prandaj biseda, komunikimi dhe debati janë veti të një kulture të lartë, e cila është gjithmonë e hapur, e vlefshme dhe krijuese“.

Kultura e huaj në sytë e një kulture tjetër shpalolet tërësisht dhe thellësisht. Një mendim e shpalos thellësinë e vet në prekjeje me mendimin tjetër. Fillon me njëfarë dialogu në të cilin mbisundon izolimi, njëanshmëria e vlerave, kuptohet e kemi fjalën për kulturat. Kulturës së përkatësisë tjetër do t’i parashtrojmë edhe pyetje të tjera, asi lloji që asnjëherë nuk mundet t’ia parashtrojmë vetes, i kërkohet dhe i hulumtojmë përgjigjet, duke zbuluar para vetes faqe të reja, thellësi të reja mendimesh. Gjithmonë, kuptohet mendojmë në seriozitetin e këtyre pyetjeve, pasi ky dialog, debat, i dy kulturave, në këtë rast të kulturës maqedonase dhe asaj shqiptare, të cilat shpeshherë nuk bashkohen dhe nuk përzihen, pasi çdonjëra prej tyre e ruan tërësinë e saj origjinale, por gjithmonë në mënyrë reciproke e pasurojnë njëra-tjetrën.

TRADITAT, ZAKONET DHE VETITË KULTURORE TEK MAQEDONASIT DHE SHQIPTARËT- KORNIZË E PËRGJITHSHME SOCIOLOGJIKE DHE HISTORIKE

Nëse e parashtrijmë pyetjen pse ekziston kultura, thjesht mund të përgjigjemi:

- njerëzit e ruajnë kulturën e tyre për t'i zgjidhur problemet e traditave të cilat janë të rëndësishme për familjet e tyre.
- sigurohet kontinuitet dhe afirmim i vlerave kulturore të një përkatësie të caktuar etnike.
- vlerat kulturore gjithmonë kanë për qëllim që në mënyrë dinamike edhe përkrah rrethanave të ndryshme të lidhen me vlerat kulturore, motivet, simbolet dhe dimensione të vlerave kulturore siç janë ato të kulturës eksplicite: gjuha, zakonet dhe traditat.
- vlerat kulturore si në kulturën e familjes maqedonase ashtu edhe tek ajo shqiptare, janë të lidhura me jetën dhe familjen, me rastin e lindjes, kurorëzimit, fillimit të fëmijës në shkollë, në fakultet, diplomim ose me rastin e vdekjes të njërit nga anëtarët e familjes, e kështu me radhë.

Është interesant të potencoj edhe një zakon që ndodh në familjet shqiptare-myslimane, kur ndërtohet shtëpi të re, theret kurban dhe vendoset në themelin e shtëpisë. Kurse kur vihet çatia, **pronari është pisë vendos dhurata, të cilat me pastaj ua ndan mjeshtëurve.** Ky zakon praktikohet edhe sot, sidomos në viset rurale, që është i ngjashëm sipas përmbajtjes edhe të familjet maqedonase. Kjo dëshmon se shumë zakone dhe tradita janë kryqëzuar gjatë historisë së gjatë të këtyre dy familjeve, maqedonase dhe shqiptare.

DASMA E GALIÇNIKUT SI SIMBOL TRADICIONAL NË MAQEDONI

Historia për fillimet e dasmës së popullarizuar të Galichnikut, si manifestim edhe sot e kësaj dite është shumë interesant. Fillimisht, banorët e Galichnikut e filluan në mënyrë teatrale duke u angazhuar që në përmjet një skenari të realizohet dasma me zakonet dhe vlerat kulturore të ruajtura të këtij vendi. Kështu dasma e parë e improvizuar e Galichnikut u mbajt më 12 qershor të v. 1958, e mbështetur nga banore lojal të Galichnikut me qëllim për të ruajtur me fanatizëm traditat dhe vlerat e shtrenjta të këtij vendi. Sipas monografisë, me titull “Faktografija za semejstvata” nga autori Gale Galev Axhieski, botuar në v.2009, dasmat realizoheshin në mënyrë të improvizuar, me status turistik ne forme te manifestimit tradicional.

DISA ZAKONE TË FSHATIT SIMNICË TË GOSTIVARIT

Simnica është fshat që i takon komunës së Gostivarit në Maqedoni, ku jetojnë vetëm banorë shqiptare. Sipas pozicionit gjeografik, fshati është i këndshëm për të jetuar. Banorët e këtij fshati, ekzistencën e sigurojnë me punët e tyre në bujqësi, blegtori dhe vreshtari.(Iljazi M. 2011).

Për zakonet e vjetra në këtë fshat, na treguan se dita e verës festohet shumë bukur pasi dalin vajzat në livadhe duke kënduar dhe duke mbledhur bereqetin në shenjë të simbolit për pasurinë e familjes. Gjithashtu edhe ditën e Shëngjergjit, në fshatin Simnicë e festojnë në mënyra shumë interesante, duke simbolizuar zakone që kanë të bëjnë me bukurinë, rritjen e flokëve, me mbledhjen e luleve, e kështu me radhë.

Edhe dasmat në fshatin Simnicë kanë karakterin e tyre të veçantë, pasi nusja në shtëpinë e dhëndrit mbërrin me kalë të stolisur dhe e përcjellë nga burrat me të afërt të familjes.

Këto janë vetëm disa sekuenca të një punimi me të gjatë, për të cilin janë bërë edhe hulumtime konkrete, por unë do të përfundoj me fjalët e autorit Petar Atanasov, i cili dite me parë botoi librin me titull “Nyjet multietnike maqedonase”, ku midis tjerash thotë:

“Që të jemi të barabartë, duhet të jemi njëlloj. Që të jemi njëlloj, duhet të përfitojmë ndryshe. Duke përfituar ndryshe, ngadalë largohemi dhe izolohehi. Ashtu të larguar dhe të izoluar, bëhemi të pabarabartë”.

UDC 316.334.3:321]:316.723-021.463(497.7)

Punim studimor

SEFER TAHIRI

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve

E-mail: sefertahiri@gmail.com, sefer.tahiri@seeu.edu.mk

**SKICË PËR MBINDËRTIMIN E MAQEDONISË
SHUMËKULTURORE DHE NDËRKULTURORE****СКИЦА ЗА ДОИЗГРАДБА НА МУЛТИКУЛТУРНА И
ИНТЕРКУЛТУРНА МАКЕДОНИЈА****Summary**

The main focus of this paper is on the relationship between multiculturalism and inter-culturalism as two concepts of contemporary societies and their application in everyday life. In particular, we examine concrete information how the Macedonian political, legal, educational, cultural and media system works by respecting contemporary principles and standards based on respect for diversity.

This topic is justified in the scientific and social aspect as Macedonia is a multiethnic and multicultural country. Peoples and cultures throughout history have lived close to each other but apart without having cultural intercourse or genuine intercultural communication.

Given the fact that Macedonia is a state with two or more parallel worlds, through this paper, we have defined the social fields both theoretically and empirically as a profound transformation necessary for a long-term intercultural concept that is basis for a stable state and a harmonious interethnic relationship. There will be institutional and informal mechanisms, which will minimize opportunities for interethnic public incidents. The design of multicultural and intercultural Macedonia cannot be just an individual or group projection, but above all it is a wide-ranging institutional set-up that needs to reform the society. Its multi-cultural objective reality should institutionally be reflected in the education system, in the culture and science as well as the media. Especially it should deal with

sanctioning of the hate speech in stadiums and other areas. The aim is not to leave these promoted concepts to remain only as political proclamations with an electoral impact.

The paper is guide for political decision-making enabling them undertake the necessary steps to make Macedonia an intercultural state, in which the differences will not be seen ethnocentrically, but will be treated as an advantage to create a state of equal citizens.

Hyrje

Në botë, pjesa më e madhe e shoqërive janë shumëkulturore përkatësisht struktura e tyre etnike është heterogjene, ndërsa vetëm një numër i paktë i shteteve kanë shoqëri me përbërje homogjene. Divergjencave kulturore në një shoqëri që prodhohen si rezultat i kulturave të ndryshme që u takojnë popujve apo grupeve të ndryshme etnike, por edhe religjioneve të ndryshme, shtytje u japin edhe lëvizjet e ndryshme të migrimit nga një vend në vend tjetër. Kështu që shumë shoqëri që më herët kanë qenë me sistem shoqëror njëkulturore, sot janë transformuar në shoqëri në të cilat ekzistojnë laramani kulturash. Sipas të dhënave, pas vitit 2010 më shumë se 70 për qind e klasave në shkollat e Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës përbëhen nga fëmijë që u takojnë etnive dhe racave të ndryshme, ndërsa shumica e shkollave fillore dhe të mesme janë multikulturore.

Për dallim nga shumë vende tjera, të cilave multikulturalizmi si koncept dhe si sistem vlerash u është imponuar, Republika e Maqedonisë diversitetin kulturor e ka të brumosur natyrshëm në thelbin e saj të ekzistencës shoqërore. Natyrisht, fjalën e kemi për përbërjen e saj faktike heterogjene, e jo për faktin se sa ky realitet multikulturore, i cili rrjedh nga dimensionin multi-etnik dhe multi-religjioz i Maqedonisë, është reflektuar në sistemin politik, ekonomik, arsimor, shkencor, kulturor- institucional, mediatik, ushtarak e të sigurisë si dhe sisteme tjera të shoqërisë. Gjithashtu kur themi se Maqedonia është shoqëri me shumë kultura nuk themi apriori se këto kultura mes vete kanë prag të lartë të tolerancës dhe se interferohen apo bashkëpunojnë mes vete.

Çdo shoqëri -shtet konkret, ka ndërtuar dhe ndërton mënyrë specifike të jetesës dhe në këtë kontekst përkufizon vlera të caktuara, të cilat për një popullatë janë të përbashkëta, karakteristike dhe të papërsëritshme, sepse kultura flet dhe është e përcaktuar nga

shoqëria dhe rrethi në të cilin krijohet. Në këtë kuptim, megjithë ekzistimin e elementeve universale kulturore, që janë karakteristike për çdo shoqëri, pa dallim të karakteristikave të tyre konkrete, këto elemente kulturore në mënyra të ndryshme manifestohen dhe praktikohen në mjediset shoqërore. Për këtë shkak themi se ekziston dallim midis kulturave. Këto dallime, mund të tejkalohen me komunikim më të mirë midis kulturave të ndryshme dhe me respektimin e tolerancën më të madhe të vlerave të ndryshme kulturore, me çka pengohen format e ndryshme të mosdurimit dhe nacionalizmi kulturor midis pjesëtarëve të kulturave të ndryshme.³¹

Çfarë nënkuptohet me multikulturalizëm në Maqedoni? Vallë a është kjo një paraqitje piktoreske e sallatave të ndryshme të vendosura me rregull në një enë, por të ndara njëra nga tjetra?

Trajtesa shoqërore mbi multikulturalizmin në Maqedoni, para së gjithash është politike- partiake dhe mediatike, ndërsa jo rrallë mbështetësit e tij inkurajohen apo dekurajohen, varësisht nga trendet dhe tendencat globale mbi efektivitetin e këtij koncepti në shoqëritë perëndimore.

Debati në nivel botëror që shtron si çështje dështimin e mulikulturalizmit, por që ka impakt në Maqedoni, u ngjall, madje u nxeh në tremujorin e fundit të vitit 2010, pas një deklarate jo shumë shpresëdhënëse mbi rezultatet e multikulturalizmit në shoqërinë gjermane. "*Natyrisht, premisa ishte që le të jetojmë tani sipas modelit multikulturor, pranë njëri-tjetrit dhe të gëzohemi për njeri-tjetrin. Kjo premisë ka dështuar, ka dështuar absolutisht*", u shpreh zëshëm kancelarja gjermane Angela Merkel në një takim para organizatës së rinisë së partisë së saj CDU-së (Unioni Demokratik Krishter)³².

Raportimet mediatike kanë regjistruar edhe deklarime tjera pesimiste mbi suksesin e këtij koncepti të ndërtimit të shoqërive bashkëkohore. Ndërsa pas zgjedhjes së Donald Tramp në postin e presidentit të ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, më 6 nëntor të vitit 2016, si kandidat i Partisë Republikane, që mbron dhe afirmon ide dhe pikëpamje konservatore, intensiteti i kritikave mbi këtë proces në nivel global sa vjen e rritet. Në mënyrë të tërthortë Tramp

³¹ Petrovski V. dhe të tjerë, *Shoqëritë multikulturore dhe distanca etnike- kulturore*, Universiteti Goce Dellçev, Shtip, i disponueshëm në http://eprints.ugd.edu.mk/8439/9/_ugd.edu.mk_private_UserFiles_daniela.jakimova_Desktop_TETOVO_Multikulturite%20opstestva.pdf, akses më 11.10.2018

³² Raport i radios gjermane Dojçe Vele, i disponueshëm në <https://www.dw.com/sq/kancelarja-merkel-thot%C3%AB-se-multikulturalizmi-ka-d%C3%ABshtuar/a-6120910>, akses më 11.09.2016

shpesh e godet diversitetin kulturor, duke shfaqur mendime negative mbi emigrantët, por edhe diversitetin religjioz. Presidenti amerikan goditi globalizmin, i cili në substancën e tij promovon konceptin e multikulturalizmit përkatësisht diversitetit. Tetë vite pas deklaratës "bombë" të zonjës së hekurt gjermane, më 25 shtator të vitit 2018, presidenti amerikan Tramp në fjalimin e tij drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara theksoi se e hedh poshtë ideologjinë e globalizimit. *"Me Amerikën do të drejtojnë amerikanët. E hedhim poshtë ideologjinë e globalizmit dhe e pranojmë doktrinën e patriotizmit"*, u shpreh Tramp.³³

Përgjigje ndaj kritikëve dhe kundërshtarëve të multikulturalizmit në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara ka dhënë sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), Antonio Guteresh, i cili vuri re se parimi i multikulturalizmit goditet veçanërisht tani, kur është më se i domosdoshëm. Guteresh tërhoqi vërejtjen ndaj populizmit në rritje dhe polarizimit midis kombeve. *"Liderët kanë mundësi ta avancojnë mirëqenien e popujve të tyre, por edhe ta promovojnë dhe mbështesin sistemin e reformuar, të përforcuar dhe të fuqizuar multikulturor"*, u shpreh Guteresh, deklaratë të cilën e veçojmë për të vënë në dijeni se debati global mbi të ardhmen e multikulturalizmit zhvillohet me tone pro et contra.

Kritikave negative ndaj multikulturalizmit është munduar tu përgjigjet Vil Kimlika, i cili është decid: pranimi i multikulturalizmit liberal nuk mund ta pengon funksionimin bazik të demokracive perëndimore. Funksionimi bazik i demokracive perëndimore matet përmes indikatorëve siç janë: paqja, stabiliteti demokratik, sundimi i ligjit dhe prosperiteti ekonomik. Kimlika thotë "Asnjë nga shtetet perëndimore të cilat janë nisur rrugës së multikulturalizmit nuk kanë rënë në luftë qytetare ose në anarki, e as që janë ballafaquar me grusht-shtet dhe nuk kanë vuajtur nga kolapsi ekonomik. Shtetet të cilat kanë pranuar "versionin e fortë" të politikave multikulture vlejné si shoqëri më të qeta, më stabile dhe me prosperitet". Me këto poenta, Kimlika kundërshton kritikët e multikulturalizmit, të cilët i theksojnë elementet e tij destabilizuese.³⁴

Projeksionet politike mbi multikulturalizmin në Maqedoni

³³ Raport i agjencisë shtetërore të lajmeve në Maqedoni- Agjencia Informative Maqedonase, i disponueshëm në <https://mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/140/134475536>, akses më 11.10.2018

³⁴ Kymlika Will, *"Multicultural Odysseys, Navigating the International Politics of Diversity"*, Oxford University Press, Oxford, 2007

Nëse e lokalizojmë debatin në Maqedoni, i njëjti përcillet me analiza dhe vrojtime të dy ekstremeve, jo vetëm politike dhe ideologjike, por edhe akademike ! Provenienca politike djathtiste, por edhe mozaiku joqeveritar që graviton kah ideologjia e djathtë mbështet konceptin se ndërtimi i Maqedonisë si shoqëri shumë=]bkulturore funksionale është mit dhe i pamundur, duke i dhënë përparësi konsolidimit të shoqërisë njëkulturore dhe me këtë edhe shoqërisë njëetnike, edhe atë duke promovuar dhe afirmuar projekte konkrete siç ishin "Shkupi 2014", Enciklopedia e Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve, projekti për shtimin e natalitetit, që i favorizonte vetëm komunat me popullatë maqedonase e shumë projekte tjera, që ishin pjesë e programit qeveritar të VMRO-DPMNE-së, pjesë e së cilës nga viti 2006 deri më vitin 2008 ishte një subjekt politik shqiptar- Partia Demokratike Shqiptare, parti e djathtë politike, ndërsa nga vitit 2008 deri më vitin 2016 pjesë e saj ishte Bashkimi Demokratik për Integrim, një parti e qendrës së djathtë, e cila doli nga ish Ushtria Çlirimtare Kombëtare, një formacion ushtarak i shqiptarëve të Maqedonisë, i cili në vitin 2001 u konfrontua me forcat ushtarake dhe policore maqedonase.

Programi i partisë qeverisëse, VMRO- DPMNE do të bëhet program i qeverisë, e cila drejtohet nga Nikolla Gruevski. I titulluar si "Rilindja në 100 hapa- e mbindërtuar dhe e zgjeruar" në asnjë moment nuk përmend krijimin e Maqedonisë multikulturore, por thekson ndërtimin e Maqedonisë shumëetnike. "Do të vazhdojmë me zbatimin e Marrëveshjes kornizë, por edhe përkundër detyrimeve nga Marrëveshja kornizë, me të gjitha fuqitë dhe mundësitë do të tentojmë edhe më tej, përmes sjelljes sonë të ndërtojmë shoqëri shumëetnike, e bazuar tek respekti i ndërsjellë dhe toleranca".³⁵

Spektri politik majtist dhe sektori joqeveritar që promovon ide dhe vizione liberale- majtiste angazhohet deklarativisht, por edhe në dimensionin programor për jetësimin e multikulturalizmit si koncept në institucione, por edhe në tërë shoqërinë e Maqedonisë. Me idenë strumbullare për "Një shoqëri për gjithë", Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë në zgjedhjet e fundit për herë të parë në historinë e Maqedonisë pluraliste mori afërsisht 50 mijë vota të shqiptarëve dhe mijëra vota të pjesëtarëve të bashkësive tjera etnike, vota këto që ishin vendimtare për të rikthyer këtë parti në pushtet

³⁵ Programi i VMRO- DPMNE-së "Rilindja në 100 hapa- e mbindërtuar dhe e zgjeruar", i disponueshëm në <https://vmro-dpmne.org.mk/files/wp-content/uploads/2013/08/Programa%202008%20WEB.pdf>, akses më 11.10.2018

pas qeverisjes 10 vjeçare të VMRO-DPMNE-së. Në programin e qeverisë së kryeministrit Zoran Zaev, pjesë e së cilës janë edhe Bashkimi Demokratik për Integrim, Lëvizja BESA (fraksioni i Afrim Gashit), Rilindja Demokratike Kombëtare, ndërsa disa muaj në fillim të mandatit edhe Aleanca për Shqiptarët, qartë nënvizohet angazhimi i qeverisë për përforcimin e Maqedonisë multikulturore. "Qeveria do të udhëheq politikë me të cilën Maqedonia do të ndërtohet si shtet qytetar i të gjithëve që jetojnë në të: maqedonasve, shqiptarëve, turqve, serbëve, vllahëve, romëve, boshnjakëve dhe të gjitha bashkësive më të vogla. Do të ndërtojmë shoqëri multikulturore në drejtim të komunikimit të zmadhuar interkulturore dhe ndërtimit të frymës për respektimin e pluralizmit kulturor. Përmes projekteve për qëllime integruese dhe përmes investimit në shtetin e paanshëm do të punojmë për uljen e dallimeve etnike, sociale dhe ekonomike midis bashkësive".³⁶

Në mbledhjen e 93-të, më 9 tetor të vitit 2018, Qeveria Zaev e miratoi Informacionin për nevojën e përgatitjes së Strategjisë Kombëtare për zhvillimin e konceptit "Një shoqëri dhe interkulturalizëm". Përgatitja dhe zbatimi i Strategjisë është në pajtim me Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë (mandati 2016-2020), si dhe në pajtim me prioritetet strategjike të qeverisë në vitin 2019. Qëllimi i saj është përmirësimi i tolerancës interkulturore në Maqedoni midis kulturave dhe bashkësive të ndryshme, si dhe përmes saj të zbatohen rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe të raportit të fundit të Komisionit Evropian.³⁷

Në vijë të krijimit të "shoqërisë së re" inkluzive, e cila do të respektojë dallimet edhe gjuhësore, një ndër hapat e parë në këtë drejtim nga shumica parlamentare ishte miratimi i ndryshimeve të reja ligjore që avancojnë gjuhën shqipe në përdorim zyrtar, por pa e definuar si gjuhë e dytë zyrtare, pasi për të ndodhur kjo nevojiten ndryshime në nenin 7 të Kushtetutës përkatësisht amendamentin V të saj, gjë që do t'i hapte rrugën përdorimit të gjuhës shqipe edhe në të gjitha nivelet e policisë, ushtrisë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit. Ligji u kundërshtua ashpër nga partia VMRO-DPMNE, e cila në vitin 2008 dhe 2011 vetë kishte miratuar Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

³⁶ Programi i Qeverisë së Maqedonisë (2017- 2020), i disponueshëm në <http://vlada.mk/programa>, akses më 11.10.2018

³⁷ Vendim i Qeverisë së Maqedonisë, i disponueshëm në <http://vlada.mk/node/15485>, akses më 11.10.2018

Bashkimi Demokratik për Integrim, si parti që doli nga ish UÇK-ja asnjëherë, që nga themelimi në vitin 2002 nuk ka dalë jashtë kornizës së Marrëveshjes së Ohrit. "BDI e sheh Maqedoninë si shtet shumetnik, në të cilin bashkësitë etnike janë bashkëthemelues, por në të njëjtën kohë edhe përgjegjës për ardhmërinë e vendit".³⁸

Përderisa dy partitë tjera shqiptare, Partia Demokratike Shqiptare dhe Aleanca për Shqiptarët, një parti e dalë nga PDSH-ja multikulturalizmin e reduktojnë në binomin kulturalist shqiptaromaqedonas. Në kontratën politike, të cilën PDSH e ofroi në korrik të vitit 2009 thuhet "PDSH-ja angazhohet për barazinë e plotë dhe përfaqësimin e drejtë të shqiptarëve në sistem, si në shfrytëzimin e begatave të sistemit, ashtu edhe në vendimmarrje. Kjo fushë do të kontrollohet me parimin e konsensusit të plotë. Këtu bën pjesë edhe ndarja proporcionale e buxhetit. Nëse kjo ndarje nuk do të ishte e barabartë, të drejtat e ofruara, do të shndërrohen në oferta të paralizueshme. PDSH kërkon themelimin e institucioneve në funksion të zhvillimit të vlerave kulturore shqiptare";³⁹

"Aleanca për Shqiptarët angazhohet që Republika e Maqedonisë të ndërtohet si shtet sovran, demokratik, shumëpartiak, i decentralizuar, duke respektuar realitetin binacional (dyetnik v.j) dhe multikulturor. Nisur nga kjo, ASH do të këmbëngul që Maqedonia të përkufizohet si shtet binacional (dyetnik v.j), i maqedonasve dhe i shqiptarëve. ASH angazhohet që të garantojë të gjitha të drejtat e minoriteteve që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, konform Konventës për Mbrojtje të Minoriteteve Nacionale të Bashkimit Evropian".

Ndërsa Lëvizja BESA promovoi konceptin e ridefinimit të shtetit të Maqedonisë. "Ridefinimi me një marrëveshje të re ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve, që do ta vendoste parimin e konsensusit të përgjithshëm në të gjitha nivelet e shtetbërjes, pra pa majorizim, do të mund të prodhonte një shtet stabil e të qëndrueshëm, kohëziv dhe me identitet të fuqishëm shtetëror, i cili do t'i afirmonte edhe identitetet e veçanta etnike në vend. Lëvizja BESA është e bindur se ridefinimit, përmes marrëveshjes së re ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve, duhet t'i paraprijë një pajtim historik

³⁸ BDI me programin politik që parashikon Maqedoninë si shtet shumëkulturore dhe shumëetnike, duke respektuar Marrëveshjen e Ohrit ishte fituese e të gjitha zgjedhjeve parlamentare dhe vendore që nga viti 2002 deri më vitin 2016. Në faqen zyrtare të BDI-së nuk ka akses tek programi i BDI-së, ndërsa platforma e saj për zgjedhjet 2016-2020 është publikuar në mënyrë gjysmake.

ndëretnik, ku do të pranohet autoktonia e shqiptarëve dhe kontributi i tyre historik në formimin e këtij shteti, ndërsa në të do të merren në konsideratë edhe pasojat që mund të burojnë nga mosrespektimi i këtij realiteti. Lëvizja BESA, duke u bazuar në përvojën e deritanishme, është e bindur se një shtet shumetnik si Maqedonia duhet të shkarkohet nga idetë e superioritetit etnik të maqedonasve dhe inferioritetit të shqiptarëve, në mënyrë që të krijojë hapësirë për dialog të mirëfilltë për të gjitha çështjet dhe pa paragjykime".⁴⁰

Projektimi i ndryshimeve normative- juridike në funksion të multikulturalizmit

Si çdo konflikt edhe ky i Maqedonisë në vitin 2001 përfundoi me marrëveshje në tavolinë. Në gusht të vitit 2001 pas negociatave në Ohër u arrit Marrëveshja paqësore, e cila garantonte që shteti bashkëkohor demokratik i Maqedonisë duhet vazhdimisht të sigurojë që kushtetuta e tij tërësisht t'i plotësojë nevojat e të gjithë qytetarëve të saj, në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare. Kjo marrëveshje avancoi statusin juridik- kushtetues të shqiptarëve në bashkësi, ndërsa në ligje të veçanta shqiptarët nuk përmenden në mënyrë të qartë, por në mënyrë jo të drejtpërdrejt si pjesëtarë të bashkësisë që përbën mbi 20 % të popullatës në Maqedoni.

Edhe pse varianti i parë i Preambulës së Kushtetutës, e miratuar më 16 nëntor të vitit 2001 kishte koncept qytetar, preambula e re e Kushtetutës shqiptarët i definon si pjesë e popullit shqiptar, ngjashëm siç i definon edhe vllahët, turqit, serbët, boshnjakët dhe romët.

Preambula

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë, populli maqedonas, si dhe qytetarët të cilët jetojnë brenda kufijve të saj të cilët janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllah, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak e të tjerë, duke e marrë përsipër përgjegjësinë për të tashmen dhe të ardhmen e atdheut të tyre, të vetëdijshëm dhe mirënjohës ndaj paraardhësve të tyre për viktimat dhe përkushtimin e përpjekjeve të tyre dhe luftës për krijimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Maqedonisë, dhe përgjegjës para gjeneratave të ardhshme për ruajtjen dhe zhvillimin e të gjithë asaj që është e vlefshme nga trashëgimia e pasur kulturore dhe bashkëjetesa në Maqedoni, të barabartë në të drejtat dhe obligimet e tyre për të mirën e përbashkët – Republikës së Maqedonisë - në përputhje me traditën e

⁴⁰ Programi i Lëvizjes BESA, i disponueshëm në <https://www.levizjabesa.mk/>, akses 10.08.2017

Republikës së Krushevës dhe vendimet e KAÇKM-së dhe të Referendumit të 8 shtatorit të vitit 1991, vendosën ta konstituojnë Republikën e Maqedonisë si shtet të pavarur, sovran, me qëllim që të vendoset dhe forcohet sundimi i së drejtës, që të garantohen të drejtat e njeriut dhe liritë qytetare, të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa, drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës individuale dhe të përbashkët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, të zgjedhur në zgjedhjet e lira dhe demokratike.⁴¹

Edhe pse preambula nuk është e detyrueshme, me qëllim që në aspektin simbolik të krijohet barazi juridike- kushtetuese mes qytetarëve, nevojitet që në të, të shmanget përmendja e popullit maqedonas dhe sintagma pjesë e popullit shqiptar si dhe pjesë e popujve tjerë, meqë është term i shpikur, i paeksploruar mirë dhe në kundërshtim me teoritë mbi identitetet. Kjo do të thotë që në Preambullë duhet të rikthehet varianti i parë para firmosjes së Marrëveshjes së Ohrit, që në qendër ka qytetarin pa dallim të përkatësisë etnike. "Shumë është e rëndësishme që shoqëria multikulturore të mos gënjehet me koncepte 'sa për sy e faqe', në kërkim të harmonisë dhe konsensusit të rrejshëm, sepse antagonizmat kulturorë janë real dhe të hapur".⁴²

Shmangia e paragjyqimeve dhe stereotipeve etnike në Maqedoni

Projeksionet politike, edhe pse dallojnë nga prizmi etnik, në fakt nuk e përjashtojnë në asnjë moment funksionalizimin e shoqërisë shumëkulturore në Maqedoni, si bazë e mirë për të pasur kohezion, tolerancë dhe mirëkuptim ndërmjet njerëzve dhe kulturave të ndryshme. Por këto projeksione politike bien ndesh me realitetin objektiv, natyrisht edhe për faktin që partitë politike, kur bëhen pjesë e strukturave institucionale- shtetërore nuk angazhohen sa duhet për zbatimin e projektit "Maqedonia shumëkulturore".

⁴¹ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, e miratuar në vitin 1991. Vendimi për shpalljen e amendamenteve IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII e XVIII të Kushtetutës së Maqedonisë u miratua më 16 nëntor të vitit 2001. E disponueshme në <https://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/UstavnaRmizmeni.pdf>, akses më 13.10.2018

⁴² Çupeska, A., *Identitetet kulturore në politikë- aspekte të multikulturalizmit*, Fondacioni Konrad Adenauer, zyra në Shkup, Shkup, 2013, i disponueshëm në http://www.kas.de/wf/doc/kas_39427-1522-2-30.pdf?141106114503, akses më 14.10.2018

Konceptin e shumëkulturalizmit në Maqedoni e "luftojnë" paragjykimet dhe stereotipet e shumta etnike, të cilat janë të pranishme sidomos në folklor, por edhe në politikë, arsim, kulturë, madje edhe në media dhe hapësirën publike të internetit.

Folklori ballkanik dhe në këtë prizëm edhe ai shqiptar dhe maqedonas është i stërbushur me paragjykiye dhe stereotipe të shumta etnike. Në shumë këngë, por edhe zhanre tjera të folklorit hasen terma, ide dhe thirrje përbuzëse, nënçmuese, madje edhe raciste ndaj "tjetrit" në kuptimin kolektiv.

Për të ilustruar dhe më shumë për të dekonstruktuar stereotipet etnike, kemi përzgjedhur dy këngë, njëra në maqedonisht dhe tjetra në shqip, të cilat semantikisht janë përplot urrejtje ndaj shqiptarëve përkatësisht sllavëve, ndërsa në këngën shqipe hasen edhe stereotipe ndaj Perandorisë Osmane.

Kënga në gjuhën maqedonase quhet "*As në qiell, as në tokë*" (*Ni na nebo, ni na zemja*)⁴³, por në *youtube* nuk ekzistojnë të dhëna mbi autorin e tekstit dhe interpretuesen e këngës. Në të thuhet:

*"As në qiell, as në tokë,
për shqiptarë⁴⁴ vend nuk ka,
dënoj o Zot, rrufeja t'i vrasë,
nga ata rrënjë të mos mbeten".*

Kënga në gjuhën shqipe quhet "Luftojmë për fitore"⁴⁵, ndërsa interpretues i saj është këngëtari i njohur shqiptar Arian Agushi, i njohur me nofkën Golden Ag. Shkëputëm disa vargje nga kënga për të nxjerr në pah tonet etnonacionaliste, madje edhe thirrjet për shfarosje të popujve sllavë.

*Zoti e ka falë këtë tokë për shqiptarë
Se lejojmë kush me mar e as me bi tjetër farë
Kush ma mur himnin pse mbet pa këngëtarë
S'dojmë tjetër ngjyrë pos flamurit kombëtar
Ndina burrë me atë flamur sot e mot nuk e ndërroj kurrë
Nuk pajtona n'ket liri sa t'ka shkije permbi urë
Ma i fortë se guri jom i etur për vatan
I msum me vra shkije e me pre sulltan.*

Janë të njohura dhe fatkeqësisht dëgjohe edhe publikisht thëniet nënçmuese për shqiptarët përkatësisht maqedonasit.

⁴³ Këngë me motive etnike antishqiptare, e disponueshme në kanalin *youtube* <https://www.youtube.com/watch?v=5hgfm90crml>, akses në 12.10.2018

⁴⁴ Përdoret termi pezhorativ "shiptari".

⁴⁵ Këngë me motive etnike antisllave, e disponueshme në <https://www.youtube.com/watch?v=9TWnl3NLobg>, akses më 15.10.2018

"Nuk ka shka të mirë."

"Uji fle, shkau nuk fle."

"Shqiptar i mirë, shqiptar i vdekur."

Hulumtimi me titull "*Narracionet në historitë tona*", i realizuar në vitin 2006, i realizuar nga Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhjen e Konfliktëve pranë Institutit të Hulumtimeve Sociologjike, Politike dhe Juridike në Shkup vë në pah se historia e popujve të Ballkanit më shumë është përdorur për thellimin e hendekut ndëretnik, sidomos midis shqiptarëve dhe maqedonasve.

Sa është i etabluar dhe i pranuar multikulturalizmi tek të rinjtë në Maqedoni? Vallë polivalenca etnike dhe konfesionale e ambientit kulturor maqedonas më shumë është faktor dezintegruës, se sa integruës në ambientin e përgjithshëm shoqëror në Maqedoni? Realiteti është i vrazhdë, veçanërisht kur bëhet fjalë për të rinjtë maqedonas dhe shqiptarë: nxënësit mësojnë në shkolla të ndara (fizikisht v.j), studentët studiojnë në fakultete të ndara, të rinjtë dalin në vende të veçanta, miqësitë ndëretnike janë të rralla, ndërsa martesat ndëretnike janë tabu e vërtetë. Theksimi dhe glorifikimi i identitetit të vet etnik dhe kulturor, krijon kushte objektive për realizimin e manipulimeve politike nga ana e liderëve të caktuar. Gjendja e këtillë vë në dijeni se komunikimi midis të rinjve, e me këtë edhe njohja dhe shoqërimi i ndërsjellë është minimal.⁴⁶

Në publikimin "*Pikëpamje teorike dhe praktike për zbatimin e integritit ndëretnik në fakultetet për arsimtarë*" thuhet se stereotipet dhe paragjykimet nxiten dhe vazhdojnë përmes sjelljes së mësimdhënësve (çka flasin dhe çka bëjnë), përmes sjelljes së nxënësve (çka flasin dhe çka bëjnë), përmes materialeve të mësimdhënies por edhe përmes aktiviteteve jashtë mësimore siç janë ekskursionet vetëm në vendet e rëndësishme për etnikumin e vet (identiteti kulturor).

Shkolla kultivon një qasje etnocentriste përmes shembujve:

- Muzika jonë është më e bukura prej të gjithave;
- Ne jemi viktimat më të mëdha në Ballkan;
- Objektet tona fetare janë më të bukurat në botë;
- Tanët janë vrarë gjatë kohës së luftës X;
- Alfabeti ynë është i pari mbi të gjithë të tjerët ngjashëm me të;

⁴⁶ Mladenovski M., "*Multikulturalizmi në mënyrë maqedonase*" (kolumnë), e disponueshme në <http://www.kumanovonews.mk/kolumna/multikulturalizam-na-makedonski-nacin>, akses më 12.10.2018

-Gjuha jonë është unikale ndaj të tjerave etj.⁴⁷

Arsimimi multikulturor paraqet proces i cili nga çdonjëri pjesëtar i shoqërisë kërkon të njeh veten dhe kulturën e vetë, në mënyrë që të jetë i aftë rrjedhimisht të kuptojë veçoritë, vlerat dhe praktikat e kulturave të të tjerëve. Të mësuarit dhe njëkohësisht respektimi i kulturave të të tjerëve është sfidë për identitetin personal, e me këtë, ky proces mundëson të mësojmë si të jetojmë së bashku në një botë multikulturore. Qëllimet e kësaj filozofie janë të orientuara në drejtim të pranimit të koncepteve bazike të kulturës si dhe të kuptuarit e mënyrave të funksionimit të shoqërisë pluraliste.⁴⁸

Meqë paragjykimet dhe stereotipet në shoqërinë tonë janë më të fuqishme se sa arsimit i integruar dhe multikulturor, nevojiten jo vetëm strategji politike dhe nisma institucionale, të cilat nuk kanë munguar si nga Ministria e Arsimit, OSBE-ja, sidomos nga Qendra për Dialog "Nansen" në Shkup, por edhe nisma konkrete nga vetë mësuesit dhe arsimtarët në arsimin fillor dhe të mesëm.

Në kohën e sotme, përfshirja e multikulturës në procesin arsimor është tendencë globale. Pikërisht arsimit multikulturor është i domosdoshëm për shoqërinë tonë, për shkak se i përfshinë aspektet e tolerancës dhe besimit ndëretnik, për të cilat mund të themi gati se mungojnë në arsimin formal. Arsimit multikulturor promovon arsimim të bazuar mbi respektin, barazinë, lirinë dhe mundësitë e barabarta për fitimin e shkathtësive dhe për rezultate pozitive në procesin arsimor.⁴⁹

Në doracakun me titull "*Të rinjtë, arsimit joformal dhe media sociale- vështrime dhe praktika*", projekt i Qendrës për Realizime Artistike "Multimedia" nga Shkupi, njëra nga autorët, Violeta Simjanovska përmend disa segmente, të cilat i prekin çështjet e

⁴⁷ Gulevska V. dhe të tjerë, *Pikëpamje teorike dhe praktike për zbatimin e integritetit ndëretnik në fakultetet për arsimtarë*, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ), Shkup, 2015, e disponueshme në <http://www.mcgo.org.mk/wp-content/uploads/2017/11/PIK%C3%8BPAMJE-TEORIKE-DHE-PRAKTIKE-P%C3%8BR-ZBATIMIN-E-INTEGRIMIT-ND%C3%8BRETNIK-N%C3%8B-FAKULTETET-P%C3%8B-ARSIMTAR%C3%8B.pdf>, akses më 15.10.2015

Zenuni- Idrizi V., *Multikulturalizmi në arsim*, Shkup, revista Centrum, numri 7, Shkup, 2017, e disponueshme në <http://centrum.mk/wp-content/uploads/2017/06/Valdeta-Zenuni-Idrizi.pdf>, akses në 10.10.2018

⁴⁹ Demirovska, E., *Multikultura në sistemin arsimor*, (Doracaku: Shkathtësitë dhe përgjegjësitë sociale të arsimtarëve dhe punonjësve profesional në shkollë). Shkup: OSCE, 2012, f.25

multikulturës, interkulturës, arsimit dhe kulturës, dhe për të cilat është e nevojshme ndërhyrja urgjente:

- Promovimi i dialogut ndërkulturor dhe shumëllojshmërisë kulturore si koncepte të jetesës;

- Zbatimi i edukimit për të drejtat e njeriut, por jo vetëm mbi baza deklarative, por ai të bëhet realitet;

- Edukim për sa i përket trashëgimisë kulturore të të gjitha kulturave që jetojnë në Maqedoni;

- Mbështetja e larmisë gjuhësore në arsim, përfshirë dhe arsimin në gjuhë amtare për të gjithë qytetarët;

